

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6067  
E hënë, 20 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Gjashtë të vdekur  
dhe 118 raste të reja  
me Covid-19 Faqe 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI AHMETI Faqe 4-5

## NUK BËJMË KOMPROMIS PËR POSTIN E KRYEMINISTRIT



Lideri i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Ali Ahmeti, ka bërë me dije se BDI-ja nuk heq dorë nga posti i kryeministrat në negociatat për qeverinë e re. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ka ardhur koha që Maqedonia e Veriut ta ketë një kryeministër shqiptar. Sipas Ahmetit, duhet të bëhet një kthesë e madhe në këtë drejtim, sepse ky shtet është edhe i shqiptarëve. Lideri i BDI-së ka treguar se për këtë çështje e ka edhe mbëshitetjen e partive të tjera politike shqiptare. Ahmeti ka deklaruar se një kryeministër shqiptar për Maqedoninë do të ishte një mesazh i mirë për rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare.

PRESIDENTI HASHIM THAÇI KTUEHET NË KOSOVË

## THAÇI PAS KTHIMIT NGA HAGA: KY PROCES DO TA VULOSË NJËHERË E PËRGJITHMONË ROLIN HISTORIK TË UÇK-së Faqe 7

Presidenti Hashim Thaçi, pas kthimit nga Haga, ku është intervistuar për katër ditë rresht nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, ka thënë se ky proces është në vazhdën e 21 vjetëve të

akuzave, shpifjeve dhe fabrikimeve mbi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri dhe shtet. Por, sipas tij, ky proces do ta vulosë njëherë e përgjithmonë rolin

historik të UÇK-së si një rol i pazëvendësueshëm dhe i patjetër-sueshëm për lirinë e fituar për të gjitha gjeneratat që do ta gëzojnë Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik



A EKZISTOJNË E DREJTA DHE MORALI? F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



A KA DISKRIMINIM GJATË TESTIMIT PËR COVID-19?! F. 11

KMDLNj

## AKTUALE



HOTI: E RIKTHYEM KOSOVËN PËRKRAH MIQVE TANË NDËRKOMBËTARË F. 5

PRESIDENCA: RINISJA E DIALOGUT TEKNIK NUK ËSHTË NË INTERESIN E KOSOVËS F. 7

## EKONOMI



PANDEMIA GODET BIZNESET, RRETH 800 MILIONË EURO MË PAK QARKULLIM FINANCIAR F. 9

BLLOKIMI I LLOGARIVE, HOTI TAKON DREJTUESIT DHE SINDIKALISTËT E TELEKOMIT F. 9

## SPORT

SELIMI: TRI KLUBET KANË MUNDËSI POTHUAJSE TË NJËJTA PËR TITULL F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADE  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Samiti i BE-së, në një klimë mosmarrëveshjesh

Bruksel, 19 korrik - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian u përpqoën të dielën për të tretën ditë radhazi të arrinin një marrëveshje stimulimi për t'i luftuar pasojat e koronavirusit, por kancelarja gjermane Angela Merkel tha se shtimi i grindjeve lidhur me nivelin e shpenzimeve nuk do të jetë i lehti për t'u kapërcyer.

Gjermania dhe Franca po kërkojnë një paketë të rimëkëmbjes ekonomike prej 1.8 trilion euro, për t'i shpëtuar ekonomitë e bllokut që përballen me recessionin më të rëndë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Çështjet më të debatueshme janë përmasat e fondit të ri të rimëkëmbjes dhe në çfarë proporcionesh duhet të jenë grantet dhe kreditë.

Disa shtete më të pasura si Holanda po kërkojnë që paketa të jetë më e kufizuar, duke nxjerrë në pah se sa të

thella janë ndarjet veri-jug brenda Bashkimit Evropian. Ndërkaq, samiti përballet me vështirësi për të arritur marrëveshje rrëth përmasave të kompensimeve që vendet më të pasura marrin nga buxheti i BE-së si dhe rrëth një mekanizmi të ri të propozuar për sundimin e ligjit, i cili mund t'i bllokonte fondet e BE-së për vendet që shkelin parimet demokratike.

Kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, vendi i të cilët sapo kishte filluar ta rimerre veten nga kriza 10-vjeçare e borxhit kur u godit nga pandemia, bëri një thirrje për unitet, duke thënë se nuk është në interesin e BE-së të duket e përcarë dhe e dobët.

"Sinqerisht shpresoj se sot do të mund ta thyejmë bllokimin" u tha ai gazetarëve në Bruksel.

Udhëheqësit, të cilët mbanin maska në fytyrë, e kanë quajtur samitin një moment




kyç për integrimin evropian gati 70-vjeçar. Zyrtarët dhe ekspertët kanë thënë se atmosfera të paparë krite ekonomike, do të shtronnte pyetje serioze rrëth qëndrueshmërisë së bllokut.

"Ka shumë vullnet të mirë, por edhe shumë pozicione (të pandryshuara). Unë do të bëj çdo përpjekje, por ekziston mundësia që të mos arrihet rezultat", ka thënë Merkel.

## Tërnava, pjesë e konferencës ku u diskutua për menaxhimin e Covidit

**PRISHTINË, 19 KORRIK (ER)** - Kryetari i Bashkësisë Islame i Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnava, ka marrë pjesë në konferencën virtuale e cila po organizohet nga Këshilli për Fetva i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Liga Botërore Islam. Në këtë konferencë në distancë me karakter ndërkombëtar po marrin pjesë myftinj nga bota islame, ministra, akademikë, studiues, mendimtarë dhe personalitetë të larta islame, të cilët po jepin kontributin e tyre për zgjidhjen e shumë çështjeve nga perspektiva islame që janë shfaqur pas pandemisë globale Covid-19 e që do të rezultonin me fetva të cilat do t'ua lehtësonin dhe ofronin zgjidhje çështjeve në jetën e myslimanëve.

Myftiu Tërnava në këtë konferencë u paraqit në sesionin e shtatë me temën "Ballafaqimi me pandeminë në aspektin sheriatik". Ai fillimisht falënderoi organizatorët e kësaj konference, duke theksuar



rëndësinë e kësaj teme. "Ne po ballafaqohemi me këtë pandemi dhe ne po mundohemi, me mundësitet që na i ka dhënë Zoti, të kontribuojmë për ruajtjen e jetës së njerëzve. Feja islame i ka kushtuar vëmendje të

veçantë ruajtjes së jetës së njeriut dhe interesat e domosdoshme prej të cilave varet jeta e njeriut. Këto domosdoshmëri janë pesë: sigurimi i fesë, identitetit, mendjes, pasardhësve dhe pasurisë. Nga këtu kuptojmë se

ruajtja e vetes mbetet parim sheriatik që nuk guxojmë që ta shpjmë në rrezik, as familjet e as shoqërinë", ka thënë myftiu Tërnava.

Duke folur për përvjën dhe kontributin që ka dhënë dhe po jep BIRK-u në luftimin dhe

parandalimin e pandemisë Covid-19, ai ka thënë se janë të përkushtuar që së bashku me institucionet gjegjëse ta ruajnë jetën e njerëzve në Republikën e Kosovës duke marrë një sërë vendimesh konform protokollit shëndetësor të kësaj pandemie. Ai ka përmendur pezullimin e faljes së namazeve në xhami. "Ky vendim ishte më i vështiri në jetën time, ku më 14 mars ishim të detyruar për shkak të situatës alarmante të pandemisë, por edhe duke parë qendrat me të mëdha të botës islame që kishin pezulluar faljen në xhami, edhe ne pezulluan faljen në xhami, por ezani është thirrur çdo kohë", është shprehur ai.

Ai ka shprehur falënderime për të gjitha ato shtete që kanë ofruar dorën e ndihmës për Kosovën, që ta kalojmë sa më lehtë këtë situatë pandemike. Ai në fund është lutur që sa më shpejt dhe më lehtë të kalohet kjo situatë dhe të kthehem i në normalitet.

## Edhe tetë viktima nga Covid-19 në Maqedoninë e Veriut

**SHKUP, 19 KORRIK** - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut ka njoftuar se edhe tetë persona të infektuar me Covid-19 kanë vdekur. Viktimat janë pesë nga Shkupi dhe një nga Tetova, Struga dhe Kërçova. Me këta, numri i përgjithshëm i viktimateve ka

arritur në 422, prej tyre vetëm në Shkup 170. Sa iu përket të infektuarve me koronavirus, në 24 orët e fundit janë regjistruar 127 raste të reja dhe prej tyre: në Shkup 57 raste, ndërsa numr më i vogël është regjistruar në 12 qytete të tjera.

Instituti i Shëndetit Publik ka thënë se edhe 83 persona janë shëruar nga Covid-19. Të dhënat i referohen testimit të 904 mostra. Që nga paraqitja e rastit të parë në muajin shkurt, në Maqedoninë e Veriut janë kryer gjithsej 85 820 teste dhe

prej tyre me Covid-19 kanë rezultuar 9 153 raste. Nga ky numër, 422 pacientë kanë vdekur, 3 921 raste janë ende aktivë, ndërsa 4 810 persona janë shëruar.

Pavarësisht numrit në rritje të infektuarve dhe të vdekurve, ministri i Shëndetësisë, Venko



Filipçë, ka thënë se institucionet nuk planifikojnë vendosjen e masave kufizuese.

# Gjashtë të vdekur dhe 118 raste të reja me Covid-19



Brenda 24 orëve të fundit në Kosovë janë shëruar 157 persona të prekur nga Covid-19, gjashtë kanë vdekur dhe janë paraqitur 118 raste të reja. Pas publikimit të këtyre statistikave, Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se numri i përgjithshëm i rasteve pozitive me Covid-19 në vendin tonë ka shkruar në 5 735, prej tyre 2 968 persona janë shëruar, 157 kanë vdekur dhe 2 632 janë raste aktive

**EPOKA  
ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 118 raste të reja me Covid-19 në vendin tonë si dhe kanë ndërruar jetë gjashtë persona. Po ky institut ka njoftuar se nga koronavirusi janë shëruar edhe 157 persona, duke e çuar në 2 968 numrin e përgjithshëm të të shëruarve. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 489 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 118 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 5 735 raste nga 31 056 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 135 raste të

vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 157 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 2 968 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 632", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina dhe Ferizaj prijnë me numrin më të madh të rasteve pozitive me Covid-19. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 48 raste, komuna Ferizaj 11 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Pejë 7 raste, komuna Mitrovicë 6 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Gjakovë 3 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Viti 3 raste, me nga 2 raste komunat: Kaçanik, Skenderaj dhe Vushtrri dhe me nga 1 rast komunat: Han i Elezit, Kamenicë, Klinë,

Kllokot, Lipjan, Obiliq dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin drejtuar qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë! Virusi është kudo! Ju lutemi përbahuni rekomandimeve! Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institut Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmët dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte të respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shëmangjen e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të

tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, dhe pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të mosbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut.

Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. "Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe mosbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse akoma ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Ne po punojmë përuju, andaj na ndihmoni pak që t'ju ndihmojmë shumë!", ka njoftuar IKShPK-ja.

**Ministri Zemaj: Masat kundër Covid-19 po jepin rezultate pozitive**

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kanë filluar të jepin rezultate pozitive. "Masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, për menaxhimin e pandemisë Covid-19, kanë filluar të prodhojnë rezultate pozitive. Ky është rezultat i kujdesit që keni manifestuar ditët e fundit duke bartur maska mbrojtëse, ruajtur distancën fizike, mbajtur higienën personale e kolektive dhe duke ngritur nivelin e përgjegjësisë dhe të sjelljes përballë një rreziku siç është Covid-19", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook". Në këtë kontekst, Zemaj ka kërkuar që të respektohen këto masa në mënyrë rigorozë. "Ne presim që këto rezultate të përmirësohen edhe më tej, ndërsa përgjegjësia na thirret që të vazhdojmë me disiplinë, kujdes, zbatim edhe më rigiroz të masave e rekomandimeve të profesionistëve me qëllim që puna e personelit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera të lehtësohen dhe shëndeti i popullatës të ruhet", ka shkruar Zemaj.

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI AHMETI

# NUK BËJMË KOMPROMIS PËR



Lideri i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Ali Ahmeti, ka bërë me dije se BDI-ja nuk heq dorë nga posti i kryeministrit në negociatat për qeverinë e re. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ka ardhur koha që Maqedonia e Veriut ta ketë një kryeministër shqiptar. Sipas Ahmetit, duhet të bëhet një kthesë e madhe në këtë drejtim sepse ky shtet është edhe i shqiptarëve. Lideri i BDI-së ka treguar se për këtë çështje e ka edhe mbështetjen e partive të tjera politike shqiptare. Ahmeti ka deklaruar se një kryeministër shqiptar për Maqedoninë do të ishte një mesazh i mirë për rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare.

**EPOKA  
ERE**

Muhamed KOÇI

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Lideri i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Ali Ahmeti, ka deklaruar se BDI-ja nuk do të bëjë kompromis me postin e kryeministrit në negociatat për formimin e qeverisë së re. Ai ka deklaruar se ka ardhur koha që Maqedonia e Veriut ta ketë kryeministrin shqiptar. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Ahmeti ka thënë se Maqedonia e Veriut u takon edhe shqiptarëve dhe se duhet të bëhet një kthesë e madhe në këtë drejtim. "Ne nuk bëjmë

kompromise me çështje të mëdha", ka thënë Ahmeti.

Ai ka deklaruar se një kryeministër shqiptar për Maqedoninë e Veriut do të ishte një mesazh i mirë për gjitha komunititetet e këtij vendit, rajonin dhe bashkësinë ndërkombëtare. Sipas Ahmetit, Maqedoni sa iu takon të tjerëve, u takon edhe shqiptarëve. "Ne e kemi në programin tonë zgjedhor që kryeministri i Maqedonisë së Veriut duhet të jetë shqiptar. Pra, duhet të bëhet një kthesë e madhe në këtë vend sepse ky shtet është edhe i shqiptarëve. Duhet t'i jepet fund monoetnisë për kreun e qeverisë.

Ky vend, sa iu takon të tjerëve, na takon edhe ne shqiptarëve. Sa kanë përgjegjësi të tjerët, po aq përgjegjësi kemi edhe ne. Do të ishte një porosi e mirë për rajonin dhe për komunitetin ndërkombëtar", ka thënë Ahmeti. Ai ka deklaruar se asnje prej partive të tjera shqiptare nuk ka dalë kundër idesë së tij për kryeministër shqiptar. Lideri i BDI-së ka paralajmëruar se shumë shpejt do të zhvillojë takime të drejtëpërdrejta me partitë shqiptare për këtë çështje. "Të gjitha subjektet politike shqiptare më përkrahin në këtë drejtim. Në ditët në vijim do të realizoj edhe takime të drejtëpërdrejta me ta.

Telefonata kam pasur me të gjitha subjektet politike shqiptare. Unë nuk dua të krijoj hegemoni, por dua që disa konsulta t'i bëj edhe me partitë politike shqiptare", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Ahmeti ka treguar arsyet e fitores së BDI-së në zgjedhjet e fundit në Maqedoni. Ai ka thënë se oferta e BDI-së ishte më e mira për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. "Unë mendoj se fituan opsonet më të mira. Fitoi strategjia dhe platforma jonë sepse kemi qenë më të mirët në garë. Ne ua kemi shpjeguar shqiptarëve ofertën tonë dhe ata i besuan ofertës sonë. Mendoj se fitimtarë na ka bërë edhe puna e së kaluarës, por edhe platforma jonë për të ardhmen e cila ishte platforma më e mirë që iu paraqit qytetarëve", ka thënë Ahmeti.

**"Epoka e re": Z. Ahmeti, BDI-ja ka shënuar fitore të rëndësishme në zgjedhjet nacionale në Maqedoninë e Veriut. Cili është vlerësimi juaj për këtë fitore?**

**Ahmeti:** Në realitet kjo ishte një fitore e radhës sepse ne kemi

pasur fitore numerikisht edhe më të mëdha përparrë në zgjedhje. Por kjo është një fitore si më e këndshme, më e ëmbël, sepse kemi fituar në përballje 7 me 1. Pra, kanë qenë gati të gjithë kundër nesh, por ne prapë kemi fituar.

**"Epoka e re": Çfarë ka ndikuar që BDI-ja të fitojë në këto zgjedhje?**

**Ahmeti:** Unë mendoj se fituan opsonet më të mira. Fitoi strategjia dhe platforma jonë, sepse kemi qenë më të mirët në garë. Ne ua kemi shpjeguar shqiptarëve ofertën tonë dhe ata i besuan ofertës sonë. Mendoj se fitimtarë na ka bërë edhe puna e së kaluarës, por edhe platforma jonë për të ardhmen e cila ishte platforma më e mirë që iu paraqit qytetarëve.

**"Epoka e re": Kjo është fitoria juaj e shtatë në zgjedhjet nacionale në Maqedoninë e Veriut. Pse shqiptarët e këtij shteti vazhdojnë t'i besojnë Ali Ahmetit dhe BDI-së ende?**

**Ahmeti:** Ne vazhdimisht jemi

# POSTIN E KRYEMINISTRIT



përpjekur që njerëzit të mos i zhgënjejmë dhe të mos i déshpérojmë me qeverisjen tonë. Ne nuk kemi qenë të tepruar në premtimet tona. Gjithnjë kemi premtuar atë që kemi mundur ta bëjmë. Njerëzit e kanë ditur kur mund të bëjmë dhe kur nuk mund të bëjmë më shumë. Pra, komunikimi i përhershëm me njerëzit dhe moszhgënimi i njerëzve na ka bërë përherë fitimtarë. Gjithashtu, ne nuk kemi qenë jogrindavecë gjatë gjithë periudhave, ne jemi përpjekur që t'i bashkojmë njerëzit e jo t'i ndajmë. Nuk jemi shumë për t'u ndarë e për t'u përcarë. Pra, filozofia dhe motoja jonë ka qenë që sa më të bashkuar aq më të suksesshëm do të jemi për realizimin e qëllimeve tona. Kemi shumë halle të qytetarëve, shumë sfida dhe shumë punë për të bërë. Vërtet janë bërë shumë punë të mira, mirëpo ende ka shumë punë që presin për t'u bërë. Dhe për këto punë, si shpresë e vetme jemi ne Bashkimi Demokratik për Integrin për realizimin e atyre qëllimeve që i kanë shqiptarët në këto hapësira.

**"Epoka e re": A i keni filluar konsultimet për formimin e qeverisë së re?**

**Ahmeti:** Tani ne jemi në qetësi. Jemi duke analizuar dobësitë që i kemi pasur dhe jemi duke ndërtuar strategjinë që

parashev hapat tanë për të ardhmen, qofshin ato për negociata, qofshin ato për platformat që duhet të zbatohen në të ardhmen përparimin e mëtutjeshëm të shtetit, por edhe të proceseve në të cilat jemi duke punuar.

**"Epoka e re": Cilat do të jenë kërkesat e BDI-së për formimin e qeverisë së re? Është përmendur edhe posti i kryeministrit.**

**Ahmeti:** Kjo çështje jo vetëm që është folur, por ne e kemi në programin tonë zgjedhor që kryeministri i Maqedonisë së Veriut duhet të jetë shqiptar. Pra, duhet të bëhet një kthesë e madhe në këtë vend, sepse ky shtet është edhe i shqiptarëve. Duhet t'i jepet fund monoetnisë për kreun e qeverisë. Ky vend, sa iu takon të tjerëve, na takon edhe ne shqiptarëve. Sa kanë përgjegjësi të tjerët, po aq përgjegjësi kemi edhe ne. Do të ishte një porosi e mirë përrajonin dhe për komunitetin ndërkombëtar, por do të ishte një porosi e mirë për të gjithë qytetarët që jetojnë në këtë vend. Sepse përgjegjësitë po i ndajmë në të gjitha drejtimet, deri edhe në drejtimin e shtetit.

**"Epoka e re": Pra, BDI-ja nuk do të hyjë në qeverinë e re pa e marrë postin e kryeministrit?**

**Ahmeti:** Ne nuk bëjmë

kompromise me çështje të mëdha.

**"Epoka e re": Besoni se maqedonasit janë në gjendje ta pranojnë një kryeministër shqiptar?**

**Ahmeti:** Nuk kam dëgjuar arsyet fortë e të qëndrueshme që mos ta pranojnë një gjë të tillë. Po të dëgjoja arsyet qëndrueshme mbante do të isha në një situatë që do të mendohesha edhe unë. Mirëpo nuk ka asnjë arsyet qëndrueshme në mënyrë absolute nga asnjëra palë.

**"Epoka e re": Po me partitë shqiptare, e keni diskutuar këtë çështje?**

**Ahmeti:** Të gjitha subjektet politike shqiptare më përkrahin në këtë drejtim. Në ditët në vijim do të realizoj edhe takime të drejtëpërdrejta me ta. Telefonata kam pasur me të gjitha subjektet politike shqiptare. Unë nuk dua të krijoj hegemoni, por dua që disa konsulta t'i bëj edhe me partitë politike shqiptare.

**"Epoka e re": Dhe besoni se edhe ata do t'ju përkrahin në kërkesën tuaj, që Maqedonia e Veriut ta ketë kryeministrin shqiptar?**

**Ahmeti:** Asnjëri nga këta nuk është deklaruuar kundër një kryeministri shqiptar të Maqedonisë së Veriut.

## Hoti: E rikthyem Kosovën përkrah miqve tanë ndërkombëtarë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka thënë se për një muaj të qeverisjes së tij e rikthyen Kosovën aty ku e vendin, përkrah miqve tanë ndërkombëtarë. "Nga një raport i lënduar me BE-në dhe ShBA-në, tani kemi mbështetje nga të gjithë për cakun e dialogut, që është njohja reciproke dhe normalizimi i marrëdhënieve. Për një muaj ne hoqëm nga çdo diskutim temën e integritetit territorial të Kosovës", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Ai ka bërë me dije se me vendosmëri dhe guxim e kanë evituar rrugën qorre dhe qasjen izoluese dhe kanë marrë përgjegjësitë shtetërore në dialog. "Këtë e bëmë pa hezitim, pasi udhëhiqe-

mi nga parimi i ruajtjes së integritetit territorial dhe unitaritetit të shtetit, si dhe nga respektimi i plotë i kushtetutshmërisë. Kjo është qasja jonë në dialog, që është legitime dhe e vetme. Koha e politikës izoluese dhe e frikës për t'u përballur është tashmë pas nesh", është shprehur ai.

Hoti ka thënë se parimet e qarta dhe sinqueritë i tyre përballë partnerëve ndërkombëtarë po mundësojnë ecjen krah tyre dhe "po na sigurojnë garancinë për proces dialogues në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj". Kryeministri Hoti ka pohuar se kjo do të jetë një marrëveshje që Kosovës i jep atë që i takon, të genit e barabartë dhe e integruar në familjen e madhe euroatlantike. "Për këtë ka nevojë populli i Kosovës", ka theksuar Hoti.



# **Hoxhaj: Qeveria, qasje të gabuar në dialog me Serbinë**

“Partia Demokratike e Kosovës e konsideron të nxituar, pa qartësi dhe pa mbështetje të nevojshme politike e institucionale takimin e kryeministrat të Kosovës, Avdullah Hoti, në Bruksel, me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Dua ta them qysh në fillim se PDK-ja nuk është kundër dialogut, por është seriozisht kundër qasjes dhe mënyrës së gabuar se si Qeveria e Kosovës po i qaset dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj

**EPOKA**  
**E BE**

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Anëtari i kryesisë i PDK-së, deputeti Enver Hoxhaj, e ka konsideruar të nxituar, pa qartësi dhe pa mbështetje të nevojshme politike dhe institucionale takimin e kryeministrat të Kosovës, Avdullah Hoti, në Bruksel, me presidentin serb Aleksandër Vuciq.

Hoxhaj ka thënë se PDK-ja nuk  
është kundër dialogut, por  
është seriozisht kundër qasjes  
dhe mënyrës së gabuar se si  
Qeveria e Kosovës po i qaset  
dialogut në mes të Kosovës  
dhe Serbisë. Ai ka theksuar se  
takimi para dy ditësh në  
Bruksel ka treguar se Qeveria e  
Kosovës nuk është e përgatitur

politikisht dhe përmbajtësisht për dialogun dhe ajo hyri në një proces të tillë, pa platformë, pa strategji, pa konsensus, pa koordinim, pa përvojë pér këtë proces dhe pa asnje ekspert. "Partia Demokratike e Kosovës e konsideron të nxituar, pa qartësi dhe pa mbështetje të nevojshme politike dhe institucionale takimin e kryeministrat të Kosovës, Avdullah Hoti, në Bruksel, me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Dua ta them qysh në fillim se PDK-ja nuk është kundër dialogut, por është seriozisht kundër qasjes dhe mënyrës së gabuar se si Qeveria e Kosovës po i qaset dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Takimi para dy ditësh në Bruksel ka treguar se

Qeveria e Kosovës nuk është e përgatitur politikisht", ka deklaruar Hoxhaj. Ai ka shtuar se si pasojë e kësaj qasje të gabuar Kosova ka rifilluar dialogun me Serbinë pa afat kohor, pa parime dhei pa unitet, duke e dëmtuar pozicionin negociuës të Kosovës. "Përgatitja e vetme është vetëbesimi naiv, i cili do të mund ta drejtojë këtë proces në një udhë pa krye", ka thënë Hoxhaj. Javën që e lamë pas kryeministri Avdullah Hoti është takuar në Bruksel me



presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Pas takimit të parë me presidentin e Serbisë në Bruksel, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se është shënuar përparim në kuadër të dialogut. Ai ka treguar se në takimin e së enjtes është diskutuar çështja e të pagjeturve dhe zhvillimi ekonomik. "Ka qenë takim i vështirë. Qëndrimin tonë e kam paraqitur në këtë takim dhe nuk do të lëviz asnjëherë nga ai qëndrim. Kjo është fazë finale e përmbylljes së

çështjeve të hapura me Serbinë", ka thënë kryeministri Hoti, duke shtuar se i gjithë procesi do të marrë disa javë ose muaj, por jo më shumë. I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka paralajmëruar një raund të ri bisedimesh të nivitet të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë në fillim të muajit shtator. Ai ka thënë se për këtë janë pajtuar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

# A ka diskriminim gjatë testimit për Covid-19?!

Nga: KMDLNj

Në mediat elektronike të Kosovës kishte të intervistuar që pohonin se, përkundër kërkjesës për t'ua bërë testin për Covid-19 për faktin se kishin dyshime, se kishin anëtarë të familjes të prekur nga ky virus, kishin sëmundje kronike që i bëjnë lehtë të cenueshëm apo kishin moshë të shtyrë, autoritetet shëndetësore i kanë refuzuar me arsyetimin se, ose nuk ka teste të mjaftueshme, ose nuk janë në listën e prioriteteve. Opinioni në Kosovë për çdo ditë po informohet për rritjen e numrit të të prekurve nga virusi sikur që edhe numri i rasteve që po përfundojnë me fatalitet dukshëm éshtë rritur.

Arsyjetimi i autoriteteve shëndetësore se i vdekuri nga Covid-19 ka pasur sëmundje tjera përcjellëse, të rënda dhe kronike, shkaktojnë huti në opinion, aq më parë që nuk po përcaktohet shkaku i vërtetë i vdekjes

Në përpjekje për ta luftuar pandeminë e shkaktuar nga



Nuk ka kuptim që të moshuarve mbi 65 vjeç, në emër të mbrojtjes së shëndetit të tyre në mënyrë drastike iu kufizohet liria e lëvizjes kurse, në anën tjetër, iu mohohet edhe drejta e testimit.

Këto kategori të qytetarëve të Kosovës duhet të kenë prioritet absolut gjatë testimit, kurse të tjerët të cilëve testi iu duhet për të lëvizur jashtë

vendi, për biznes apo arsyetë tjetra e që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e sipërpermendura, me rrezikshmëri të lartë të infektimit si dhe me kapacitetin të madh për t'i infektuar të tjerët, mund ta bëjnë testimini në institucionet shëndetësore private dhe jo ta ngarkojnë sistemin shëndetësorë publik. KMDLNJ mendon se pikërisht përgjedhja diskriminuese, e jo

në bazë të nevojës së domosdoshme për testim, ka shkaktuar dhe po shkakton rritjen e numrit të të prekurve sikur edhe rritjen e numrit që po përfundon me fatalitet andaj kërkon transparencë dhe monitorim të këtij procesi si dhe qasje në lista, nëse ka të tilla, pas të cilave ndërmerrin veprimet. Qytetarët e Kosovës shumica e tyre nuk kanë mundësi t'i paguajnë testet, prandaj këto duhet të sigurohen falas përjashtuar ata që e kanë këtë mundësi.

KMDLNj kërkon që të rritet numri i testimeve, kurse nga Qeveria e Kosovës kërkon të ndajë mijte shtesë për këtë qëllim sikur edhe për

punëtoret shëndetësorë.  
KMDLNj përkrah kërkesat e drejta të grupeve të cenesëshme e që i janë drejtuar KMDLNj-së për testim në bazë të nevojave e jo në baza diskriminuese. Mbrojtja cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët është e drejtë e njeriut dhe, si e tillë, duhet të respektohet nga autoritetet shëndetësore dhe jo vetëm shëndetësore kosovare.

Presidenti Hashim Thaçi kthehet në Kosovë

# Thaçi pas Hagës: Ky proces do ta vulosë njëherë e përgjithmonë rolin historik të UÇK-së

Presidenti Hashim Thaçi, pas kthimit nga Haga, ku është intervistuar për katër ditë rresht nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, ka thënë se ky proces është në vazhdën e 21 vjetëve të akuzave, shpifjeve dhe fabrikimeve mbi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri dhe shtet. Por, sipas tij, ky proces do ta vulosë njëherë e përgjithmonë rolin historik të UÇK-së, si një rol i pazëvendësueshëm dhe i patjetësueshëm për lirinë e fituar për të gjitha gjeneratat që do ta gjelojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe demokratik.

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se e respekton procesin për zbardhjen e së vërtetës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, për rolin e tij në ish-Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Thaçi, gjatë një adresimi përmes

dhe sakrifisen e një populli të tërë në luftën për liri por, përkundrazi, nga ky proces, cilado qoftë rrjedha dhe kohëzgjatja e tij, historia e lavdishme e rezistencës, mbijetesës dhe triumfit mbi një pushtues, që kerkoi ta shfaroste popullin shqiptar të Kosovës nga faqja e dheut me fshesën e fashizmit etnik, do të bëhet njëherë e përgjithmonë e



proces "është në vazhdën e 21 vjetëve të akuzave, shpifjeve e fabrikimeve mbi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri dhe shtet". "Por, ky proces do ta vulosë njëherë e përgjithmonë rolin historik të UÇK-së si një rol i pazëvendësueshëm dhe i patjetësueshëm për lirinë e fituar për të gjitha gjeneratat që do ta gjelojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe demokratik", ka thënë Thaçi. Sipas Thaçit, për të "Kosova është gjithnjë e para". "Nëse për Kosovën isha gati të jap jetën kur isha një djalë i ri, sot që jam një prind me thinja nuk kam fare dyshim se detyra ime është ta mbroj Kosovën, duke mos lejuar që procesi ku më kanë përfshirë

mua dhe bashkëluftëtarët e mi krejt padrejtësish, t'i pengojë punët e mëdha që ka përpara Kosova", ka theksuar presidenti i Kosovës.

Thaçi, po ashtu, ka folur edhe për dialogun me Serbinë, ku ka bërë thirrje për unifikim rreth këtij procesi. "Njëkohësisht duhet t'i flasim botës me një zë dhe ta zhvillojmë dialogun me Serbinë me një unitet shembullor çfarë e kishim në Rambuje, në Vjenë dhe në Bruksel", ka deklaruar ai.

Sipas presidentit Thaçi, forcat politike në vend duhet të kenë dialog të civilizuar dhe unitet politik. "Kosova sot ka nevojë më shumë se kurrë për dialog të civilizuar mes forcave politike, për stabilitet institucional, për qeverisje të mirë dhe unitet

qytetar e politik, veçanërisht në dialogun për njohjen e saj përfundimtare nga Serbia dhe nga krejt bota", është shprehur Thaçi.

Ai, gjithashtu, u ka bërë thirrje të gjithëve që ta vendosin Kosovën mbi dallimet politike partiake, mbi hatërbetjet dhe pakënaqësitë e përditshme.

Nga 13 deri më 16 korrik Thaçi është intervistua nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Pas përfundimit të intervistikut, Thaçi ka deklaruar se i mbetet prokurorit dhe gjykatësit të vlerësojnë me "paanshmëri dhe me mendje ta hapur dëshminë" e tij. Nëse ata e bëjnë një gjë të tillë, është shprehur Thaçi, atëherë ata "lehtë mund të vijnë në përfundimin se unë se nuk kam bërë asnjë lloj krimi apo shkelje të pretenduara".

Thaçi është ftuar për intervistikun në Hagë pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar muajin e kaluar se më 24 prill ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër tij, kundër kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe disa të tjera, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë. Thaçi, pas kthimit nga Haga, në pikën kufitare në Morinë është pritur nga shumë qytetarë të Kosovës.



rrjetit social "Facebook", ka bërë thirrje për dialog mes forcave politike në Kosovë, për debat të shëndetshëm mes qeverisë dhe opozitës si dhe ka theksuar nevojën për unitet në raport me dialogun me Serbinë.

Gjatë këtij adresimi, që është i pari pas kthimit nga Haga, Thaçi ka pohuar se historia e rezistencës së Kosovës do të bëhet njëherë e përgjithmonë e paprekshme nga askush. "Sot ju them me bindje se ky proces jo vetëm që nuk do ta rishkruejë këtë histori të shkruar me gjakun

paprekshme nga askush", ka thënë Thaçi, duke shtuar se nuk mund të rishkruhet historia e Kosovës.

Ai ka thënë se në Hagë ka përfunduar rreth 30 orë ballafaqim me organin e akuzës ku është njoftuar për pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe u është përgjigjur pyetjeve të tyre. "Kam respekt të plotë për procesin e zbardhjes, deri në fund të së vërtetës dhe të rolit tim në luftën çlirimtare për liri dhe pavarësi", ka deklaruar Thaçi. Ai ka shtuar se ky

## Presidenca: Rinisja e dialogut teknik nuk është në interesin e Kosovës

**PRISHTINË, 19 KORRIK (ER)** - Shefi i kabinetit i presidenit të Kosovës, Hashim Thaçi, njëherësh këshilltar kryesor politik i presidentit, Bekim Collaku, thotë se qëllimi i dialogut me Serbinë duhet të jetë marrëveshja përfundimtare me njohje reciproke dhe jo rinisja e

në dialogu teknik të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. "Rinisja e dialogut teknik, i udhëhequr nga BE-ja, nuk është në interesin e Kosovës. Ai është dizajnuar për ta justifikuar hapjen e më shumë kapitujve për pranimin e Serbisë në BE, teksa e lë Kosovën të

izoluar dhe në status quo. Qëllimi duhet të jetë marrëveshja përfundimtare politike me njohje reciproke", ka thënë Collaku përmes një postimi në rrjetin social në "Twitter". Ky reagim i Collakut vjen pasi më 16 korrik kryeministri i Kosovës, Avdullah

Hoti, është takuar në Bruksel me presidentin serb Aleksandar Vuçiq në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Pas kësaj, Brukseli ka paralajmëruar se dialogu në nivelin teknik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rinisë të mërkurën, më 22 korrik.



Intervistë me drejtorin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Ramiz Krasniqi

# Mbi 15 milionë euro janë të hyrat e KPMM-së në gjashtëmuajrin e parë të këtij viti



Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ramiz Krasniqi, ka thënë se komisioni që drejtton edhe në këtë kohë pandemie ka vazhduar punën në harmoni me planin e Qeverisë së Kosovës. Krasniqi në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka thënë se për periudhën janar-qershor është shënuar rënie e të hyrave vetëm dy për qind. Duke folur për kushtet në minierë, ai ka theksuar se kushtet e minierës janë në përputhshmëri me sistemin e shfrytëzimit nëntokësor dhe parametrat e lejuar minerar. "Kjo nuk do të thotë se këto kushte janë të sigurta, me faktin se kemi të bëjmë me punime nëntokësore dhe se rrezikshmëria e punës është shumë më madhe se në minierat sipërfaqësore", ka thënë Krasniqi

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ramiz Krasniqi, ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive globale të shkaktuar nga pandemia Covid-19, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka vazhduar punën në harmoni me planin e Qeverisë së Kosovës dhe për periudhën janar-qershor, është shënuar rënie e të hyrave vetëm 2 për qind. "Në të dhënët që i tregon raporti i periudhës janar-qershor 2019 në krahasim me

periudhën e njëjtë të këtij viti, përkatësisht janar-qershor 2020, ka pasur rënie të të hyrave vetëm për 2 për qind. Në total të hyrat gjatë muajve janar-qershor e kapin shifrën e 15 milionë e dyqind e 48 mijë e 96 euro e 16 cent, kurse në periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat ishin 15 milionë e 772 e 970 euro e 95 cent, pra kemi një rënie të ulët në të hyra, vetëm 2 për qind", ka thënë Krasniqi.

Në këtë intervistë dhënë përgazetën "Epoka e re", Krasniqi ka folur edhe për vdekjen e dy punëtorëve të "Trepçës". Ai ka thënë se lëndimi me fatalitet ka

ndodhur pikërisht nga mosvlerësimi i drejtë i situatës para aksidentit nga ana e stafit tekniko-mbikëqyrës për potencialin e rrezikut nga shembja. "Raporti i komisionit hetues është përfunduar me të nxjerra nga rekomandimet e veta lidhur me aksidentin dhe ka konstatuar se 'lëndimi me fatalitet ka ndodhur pikërisht nga mosvlerësimi i drejtë i situatës para aksidentit nga ana e stafit tekniko-mbikëqyrës për potencialin e rrezikut nga shembja'. Për më tepër rrëth këtij rasti raporti do t'u përgjigjet edhe organeve të tjera hetuese dhe institucionale përmes

## Bllokimi i llogarive, Hoti takon drejtuesit dhe sindikalistët e Telekomit

**PRISHTINË, 19 KORRIK (ER)** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuqi, ka takuar drejtuesit dhe sindikalistët e Telekomit të Kosovës, me të cilët ka diskutuar përgjendjen e krijuar pas bllokimit të llogarive të Telekomit si dhe për hapat që duhen marrë për tejkalinin e kësaj gjendjeje. Edhe ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuqi, gjatë javës që lamë pas ka

takuar bordin, menaxhmentin dhe Sindikatën e Telekomit të Kosovës. Temë bosht e takimit të tyre ishte gjendja e krijuar së fundi në Telekomin e Kosovës pas bllokimit të xhirollgarive bankare nga përbartuesi privat.

Ministri Kuçi ka kërkuar nga drejtuesit e organeve të Telekomit që të raportojnë në tërësi përrnjë e këtij rasti dhe për hapat që janë ndjekur në secilën fazë. Gjithashtu, nga menaxhmenti u kërkua të raportohet përfomancën

e tanishme të kësaj ndërmarrje publike. Përpos diskutimit, ministri ka kërkuar nga bordi i ndërmarrjes që të propozojnë rekomandime për dalje nga gjendja e bllokimit të xhirollgarive bankare dhe përvazhdimin tutje të funksionimit të ndërmarrjes. Ndërsa Sindikatës së Telekomit i ka thënë se bashkëndiejnë me punëtorët, të cilët janë të shqetësuar përsituatën, pikërisht në këtë kohë pandemie.



ta konstatuar vlerësimin e komisionit hetues të KPMM-së, është shprehur ai.

**“Epoka e re”:** Z. Krasniqi, sa ka ndikuar pandemia në sektorin minerar dhe cilat janë të hyrat e realizuara në periudhën mars-qershor dhe si qëndron raporti me periudhën e njëjtë të vitit paraprak?

**Krasniqi:** Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në harmoni me vendimet e Qeverisë së Kosovës ka arritur ta menaxhojë situatën e krijuar në vend, duke përfunduar me sukses të gjitha punët e parapara si institucion, si dhe ka bërë ruajtjen e kontinuitetit të aktiviteteve minerare në vend. Në të dhënët që i tregon raporti i periudhës janar-qershor 2019 në krahasim me periudhën e njëjtë të këtij viti, përkatësisht janar-qershor 2020 ka pasur rënje të hyrave vetëm për 2 për qind. Në total të hyrat gjatë muajve janar-qershor e kapin shifrën e 15 milionë e dyqind e 48 mijë e 96 euro e 16 cent, kurse në periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat ishin 15 milionë e 772 e 970 euro e 95 cent, pra kemi një rënje të ulët në të hyra, vetëm 2 për qind.

**“Epoka e re”:** Si është duke ecur procesi i prodhimit në minierat më të mëdha si “Trepça” Sh. A., KEK-u, “Newco Ferronikeli Complex” LLC dhe “SharrCem”?

**Krasniqi:** Nga minierat e Trepçës, “Trepça” Sh. A., sasia e prodhuar e xehes së plumbit dhe zinkut për tremujorin e parë të vitit 2020 është rrith 12 për qind më i lartë se në tremujorin e parë të vitit (TM1) 2019. Në minierat e KEK-ut, sasia e prodhuar e linjitet për tremujorin e parë të 2020-s është rrith 2 për qind më e lartë se në tremujorin e parë të vitit 2019. Minierat e “Newco Ferronikeli Complex” LLC, sasia e prodhuar e xehes së Ni-Co për tremujorin e parë 2020 është 100 për qind më e lartë se tremujorin e parë të vitit 2019, në (TM1) 2019 nuk ka pasur fare prodhim. Në minierën “Sharr Cem” Sh. P. K. sasia e prodhuar e mergelës për TM1 - 2020 është rrith 49 për qind më e vogël se TM1-2019.

**“Epoka e re”:** Në çfarë kushtesh punohet në këto miniera dhe sa janë të siguruar punëtorët pasi muajin që lamë pas humbët jetën dy minatorë të “Trepçës”?

**Krasniqi:** Kushtet e minierës janë në përputhshmëri me sistemin e shfrytëzimit nëntokësor dhe parametrat e lejuar minerar. Kjo nuk do të thotë se këto kushte janë të sigura me faktin se kemi të bëjmë me punime nëntokësore dhe se rezikshmëria e punës është

shumë më madhe se në minierat sipërfaqësore. Të papriturat nga shembjet në disa raste mund të janë të paparashikuara dhe jo të analizuara shkencërisht, por me faktin se vdekshmëria ka qenë e vogël nuk mund të themi se ka rrezikshmëri të lartë duke referuar statistikat nga paslulta deri në aksidentin e fundit 2020 (kemi zero vdekshmëri).

**“Epoka e re”:** Po ashtu, KMPP-ja kishte formuar një komision nga Inspektorati i Minierave. A është shqiptuar ndonjë dënim apo kush duhet ta bartë përgjegjësinë për këtë aksident?

**Krasniqi:** Raporti i komisionit hetues është përfunduar me të nxjerra nga rekandimet e veta lidhur me aksidentin dhe ka konstatuar se “lëndimi me fatalitet ka ndodhur pikërisht nga mosvlerësimi i drejtë i situatës para aksidentit nga ana e stafit tekniko-mbiqëqyrës për potencialin e rrezikut nga shembja”. Për më tepër rrith këtij rasti rapporti do t’u përgjigjet edhe organeve të tjera hetuese dhe institucionale për ta konstatuar vlerësimin e komisionit hetues të KPMM-së.

**“Epoka e re”:** Po ashtu, sa i përket inspektimit nga ana e KPMM-së, a keni hasur në mospërfillje rregullash gjatë periudhës mars-qershor dhe a është shqiptuar ndonjë gjybë?

**Krasniqi:** Në bazë të të dhënave që kemi në KPMM, gjatë periudhës mars-qershor janë lëshuar 14 vendime për gjoba, në bazë të raporteve nga terreni për shkak të veprimeve të jashtëligjshme.

**“Epoka e re”:** Sa minime janë realizuar në periudhën mars-qershor dhe si është raporti me vitin e kaluar?

**Krasniqi:** Minimet masive të realizuara në periudhën mars-qershor 2020 janë 159. Raporti me vitin e kaluar në periudhën mars-qershor 2019 është 178 minime masive. Diferencia është 19 minime masive më pak se në vitin 2019.

**“Epoka e re”:** Po ashtu, na flisni edhe për numrin e licencave të hulumtimit, shfrytëzimit, si dhe lejeve për aktivitete të veçanta?

**Krasniqi:** Deri më tanë, sa i përket vitit 2020, licencat dhe lejet e lëshuara janë: hulumtime 26, për shfrytëzim 21, si dhe aktivitete të veçanta 19. Pra, totali është 76 sosh. Ndërsa në total numri i licencave aktive është: Hulumtim 162 sosh, shfrytëzim 196, aktivitete të veçanta 305.

**“Epoka e re”:** Sa operatorë ilegalë të resurseve natyrore keni evidentuar?

**Krasniqi:** Janë gjithsejtë njëzet e pesë operatorë ilegalë të identifikuar për vitin 2020.

# Pandemia godet bizneset, rrith 800 milionë euro më pak qarkullim financiar

Prishtinë, 18 korrik -

Qarkullimi i bizneseve në vend ka rënë për rrith 800 milionë euro vetëm brenda tre muajve në pandemi. Ndonëse çdo ditë e më shumë është duke u vështirësuar veprimtaria e bizneseve, është kërkuar nga qeveria që të gjejë forma dhe mundësi për të futur para në funksion për mbështetjen e qytetarëve në mënyrë që të ruhen edhe vendet e punës. Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë për “Kosovapress” se Covid-19 ka pasur ndikim të theksuar edhe në aspektin ekonomik. Një gjë e tillë Murtezaj ka thënë se ka ndikuar në rënien e qarkullimit financiar të kompanive. Murtezaj ka theksuar se në muajin mars ka pasur 16 për qind rënje të qarkullimit financiar, në prill 41 për qind dhe në muajin maj 28 për qind. “Covid-19, përvëc ndikimeve në shumë sfera si në aspektin shëndetësor dhe ekonomik, një ndikim të theksuar ka dhënë edhe në pagesën e tatimeve. Në këtë rast nga të dhënët zyrtare që ne i kemi, kemi rënje të theksuar të qarkullimit gjatë këtyre tre muajve, mars-prill-maj, edhe në qershor. Në muajin mars kemi një rënje të qarkullimit në raport me marsin e vitit 2019 për 142 milionë euro. Në muajin prill kemi 378 milionë euro, në maj 268 milionë euro. Totali

i rënies së qarkullimit për këta tre muaj është mbi 791 milionë euro qarkullim më të ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit 2019”, thekson ka thënë Murtezaj.

Ndërsa drejtoresha ekzekutive e Rrjetit të Shitësve me Pakicë, Yllka Metaj, ka thënë për “Kosovapress” se rënia e qarkullimit në sektorin e shitjes me pakicë ka rënë mbi 120 milionë euro dhe çdo ditë e me shumë, sipas saj, është më e vështirë për të mbijetuar këto biznese. Ajo ka kërkuar mbështetjen e shtetit për biznese, pasi kufizimi nga masat mbrojtëse anti-Covid, veçanërisht në gastronomi, ka ndikuar edhe në mbylljen e vendeve të punës. “Jemi duke folur për mbijetesë të bizneseve ku çdo ditë është më e vështirë, duke marrë parasysh që prej institucioneve shtetërore nuk është dhënë ende përkrahja. Pakoja emergjente, e cila është folur, është duke vështirësuar krejt procesin e mbarëvajtjes së punës. Anëtarët tanë nga kategoritë ndryshme janë edhe marketet. Konsumi, një ka rënë për 25 për qind, kjo ka ndikuar në 20 për qind të qarkullimit. Nëse flasim për gastronomi, atëherë numrat janë edhe më të mëdhenj për arsy se ka pasur ndalesë të tërësishme brenda një periude të caktuar. Tregtarët e tjere me pakicë në mobilieri ose teknologji, kështu që varësish

prej industrisë, prej kategorisë dallon edhe përqindja e rënies së qarkullimit... (12'18) Nëse përafërsisht anëtarët tanë kanë qarkullim 600 milionë euro, atëherë 20-përqindëshi i rënies i bie rrith 120 milionë euro”, ka thënë ajo.

Në anën tjeter, eksperti i ekonomisë, Safet Gérxhaliu, ka thënë se është koha e fundit që institucionet e shtetit duhet ta mbështesin sektorin privat për ta shtuar qarkullimin e bizneseve dhe rritjen e prodhimit. Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës i ka propozuar qeverisë që ta hulumtojë mundësinë e gjetjes së parasë për ta futur në funksion. “Nëse nuk do të kemi rritje të konsumit, atëherë si mund të kemi një tregti të mirëfilltë, si mund të kemi qarkullim dhe rritje të prodhimit. Ky është një indeks zinxhir që vërtet po e ngufat ardhmërinë e Kosovës. Dua të besoj se rekandimet kryesore për Qeverinë e Kosovës është t'i hulumtojë mundësitë e gjetjes së parasë për t'i futur në funksion. Tani është koha kur dora e shtetit duhet të jetë në funksion të shtetit, në funksion të zhvillimit ekonomik, në funksion të biznesit dhe qytetarëve të Kosovës”, ka thënë ai. Gérxhaliu ka theksuar se nuk duhet të rezistohet për sa i përket rritjes së borxhit publik, sepse me Ligjin për financa publike mundëson huamarrje deri 40 për qind të GDP-së.



# Gjilani e Instituti për Zhvillim dhe Integrin mbështetin ndërmarrësit e rinj

**GJILANI, 19 KORRIK (ER)** - Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Gjilan, Deniza Limani, ka mbajtur takim pune me Institutin për Zhvillim dhe Integrin, ku u ka bërë thirrje të rinjve të aplikojnë në projekt-trajnim që financohet nga Departamenti i Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), i cili ka të bëjë me aftësimin e të rinjve në ndërmarrësi dhe ide përbiznes.

Në fjalën e saj, drejtoresha Limani ka inkurajuar të rinjtë që të aplikojnë në këtë projekt-trajnim për ndërmarrësi, sepse në

të ardhmen shumë më lehtë do ta kenë mundësinë që ta nisin biznesin e tyre dhe njëkohësisht edhe të krijojnë vende të reja pune. "Ky projekt që implemen-tohet nga Instituti për Zhvillim dhe Integrin do të trajnojë rreth 40 të rinj të cilët më pas do të kenë të drejtë aplikimi për grantet e ndërmarrësise nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Njëkohësisht do të mar-rin edhe përkrahje për idetë e tyre biznesore. Apeloj që të aplikojnë të gjithë të rinjtë nga mosha 18-24 vjet dhe urojmë që ky projekt t'u shërbejë atyre për

zhvillimin e idesë në të bërit biznes gjatë të ardhmes", ka thënë Limani. Ndërsa përfaqësuesit e Institutit për Zhvillim dhe Integrin kanë potencuar detajet që parashev projekti për aktivizimin dhe përgatitjen e të rinjve në zhvillimin e ideve biznesore dhe ndërmarrësise. Gjithashtu, ata kanë njoftuar se pjesëmarrësit e trajnimit do të kenë të drejtë aplikimi në financim për grantet që i shpallë MKRS-ja sipas kalendarit të saj. Temat e trajnimit do të janë për njojuritë themelore në ndërmarrësi,



hyrje në ndërmarrësi dhe planifikim të biznesit, administrim biznesi, menaxhim, marketing dhe shtije, hartim i biznesplaneve sipas kërkesave të MKRS-ja dhe donatorëve të tjera, prezantimi dhe paraqitja e ideve dhe planifikimi financiar.

## Nënshkruhet marrëveshja për vendosjen e 100 shportave ricikluese në Kamenicë



**KAMENICË, 19 KORRIK (ER)** - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka nënshkruar marrëveshje me Luciano Guido nga "Solar Outdoor Media Kosovo", për dhënien më shfrytëzim të hapësirës publike për vendosjen e shportave ricikluese në 100 lokacione, në qytet dhe fshatrat e Kamenicës. Këto shporta ricikluese do të funksionojnë me anë të energjisë solare dhe do të ketë mundësi përmbytje të telefonave, do të janë të pajisura me "Wifi", hapësira për reklamë dhe ndarjen e materialeve të cilat do të

dërgohen për reciklim. Me këtë rast, Kastrati ka thënë se shportat ricikluese po vendosen për herë të parë në Kamenicë. "Për herë të parë në Kamenicë po sjellim shportat ricikluese. Me z. Luciano Guido nga 'Solar Outdoor Media Kosovo', nënshkruam marrëveshjen për dhënien më shfrytëzim të pronës komunale për vendosjen e shportave ricikluese. Këto shporta do të vendosen në 100 lokacione në qytet dhe fshatra të komunës sonë, ndërkohë funksionimi i tyre do të bëhet me energji solare. Në të do të ketë mundësi përmbytje të

telefonave, 'Wifi', hapësira për reklamë dhe ndarjen e materialeve të cilat do të dërgohen për reciklim. Falënderoj bashkëqytetarin tonë nga diaspora, Kujtim Robellin, për angazhimin në këtë projekt tejet me rendësi për komunën tonë", ka thënë Kastrati. Pjesëmarrës të tjera në këtë takim ishin edhe drejtoresha e Drejtorisë për Diasporë dhe Zhvillim Ekonomik, Majlinda Krasniqi, udhëheqësi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, Hysen Jerliu dhe bashkatdhetari Kujtim Robelli.

## Fillon kubëzimi i disa rrugëve në lagjen "2 Korriku" në Mitrovicë

**MITROVICË, 19 KORRIK (ER)** - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në kuadër të projekteve përmirësimin e infrastrukturës rrugore këto ditë ka filluar rregullimin e rrugëve me kubëza në pesë rrugë të lagjes "2 Korriku" në Mitrovicë. Me këtë rast, drejtori Naser Muja së bashku me udhëheqësin e Njësisë për të Drejtat e Njeriut, Fitim Rama, kanë inspektuar punimet që po zhvillohen në këto rrugë dhe të cilat po realizohen si rrjed-

hojë e identifikimit të prioritetave në komunitet. Kubëzimi i këtyre rrugëve është pjesë e projektit "Ndërtimi i rrugëve dhe trotuarave me kubëza betoni", të bashkëfinancuar nga Komuna e Mitrovicës me 80 për qind dhe programi Romacted të Këshillit të Evropës/Bashkimit Evropian me 20 për qind. Gjatësia e rrugëve në fjalë është mbi 600 metra, gjëresia përafërsisht 4 metra, ndërsa vlera totale e këtij projekti përkubëzimin e rrugëve arrin



## Policia konfiskon 150 kg mish në Istog, transportohej në kushte johigjenike



**ISTOG, 19 KORRIK (ER)** - Policia e Kosovës në Istog ka kapur 150 kilogramë mish, i cili transportohej në kushte johigjenike. Sipas njoftimit të policisë, derisa patrulla e Stacionit Policor në Istog ishte në pikë kontrolli në fshatin Gurrakoc, ka ndaluar

personin e dyshuar i cili ishte duke vozitur automjetin "VW Caddy" me targa vendore, ku gjatë kontrollit të automjetit në bagazhin e tij i është gjetur sasia e mishit. "I dyshuari së bashku me automjetin është shoqëruar në Stacionin

Policor Istog për intervistik, janë njoftuar inspektorët sanitare dhe Prokurori i Shtetit. Nga inspektorët sanitare është bërë inspektimi i mishit dhe sipas inspektorëve sasia e mishit ishte rreth njëqind e pesëdhjetë (150) kg. Dhe, pasi që nga i

dyshuari nuk është prezantuar ndonjë dokument përcjellës, sasia e mishit nën përcjellje të Policisë së Kosovës dhe inspektorëve sanitare është bërë asnjësimi i mishit në deponinë e mbeturinave", ka njoftuar Policia e Kosovës.

# A EKZISTOJNË E DREJTA DHE MORALI?



**Shkruan: Kudusi LAMA**

Kam ndjekur me vëmendje të gjitha reagimet ndaj deklarimeve të zotëri Martyt dhe prej tyre kam mbetur para një pyetjeje në mendjen time: A ekzistojnë e drejta dhe morali te zotëri Marty?

Lexova një ditë një shkrim të një studenti në atë kohë kur ka shkruar shkrimin në John Jay College of Criminal Justice në New York, i quajtur Dimal Basha, i cili rekomandon të kujtojmë:... proverbin e Mark Twainit që e shkroi para 100 vjetësh, "derisa e vërteta i lidhë këpucët, gënjeshta e shëtitë gjysmën e botës".

Duke e falenderuar Dimalin për këtë tërheqje vëmendje, bindem edhe një herë se nuk ka as farë ndjenjë të drejtë dhe morali në veprën e zotëri Martyt, e shprehur në deklaratën serbe, e i quajtur raport evropian.

"Pas dështimit politik në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, besoj se Vuk Jeremiqi shkon në pushimet festive i relaksuar nga 'Dick-fitorja' e fundit diplomatike. Raporti i fundit i Dickut, jo që njollosi politikanët tanë, por arriti ta njollosë gjithë popullin shqiptar që luftoi për t'i mbijetuar një regjimi që tentoi të shfarosë një popull të tërë", shkruante Dimali.

Po citoj Dimalin sepse nuk di të ketë përcaktim më të quartë se ky për padrejtësinë dhe pamoralësinë e reportit të zotit Marty. Unë, thotë djali, e njoh Kosovën nëpërmjet mediave, ashtu si edhe shumë të tjerë, pasi pak njerëz shkojnë apo kanë mundësi të shkojnë për ta parë gjendjen në vend. E mediat i morët peng ju zoti Marty me shpifjet tuaja. Por ja që edhe atje në Amerikë ka djem që nuk lënë të kalojnë pa svaruar opinionin mbi vlefshmërinë e të drejtës dhe moralit në reportin tuaj e, për rrjedhojë, në personalitetin tuaj.

Ne e kuptojmë se qëllimi juaj është që të na reklamoni para botës moderne si një komb barbar që nuk njeh tjetër veçse krimin. Dhe të jeni i sigurt që për ata që mendojnë si ju, ia keni arritur qëllimit. Por edhe në opinionin e thjeshtë që nuk ka mundësi të bëjë analizë të logjikës së ftohtë, keni ndikuar. E kjo vërteton plotësisht faktin se ju nuk e keni bërë këtë report duke vënë para vetes të drejtën dhe moralin, por padrejtësinë dhe amoralitetin. Prandaj edhe mendoj se në opinion na keni dëmtuar.

Të dëmtosh një komb me shpifje të përgjithësuar, do të thotë që mbi moralin ta vësh krimin. A pranoi zoti Marty se jeni kriminel në vlerësimin e kombit shqiptar dhe për dëmin që i keni bërë botërisht? A e kishit menduar që më parë se cili do të ishte roli i këtij rapporti në opinionin e gjerë për një komb të tërë? Vërtet a nuk iu duket vetja i padrejtë me shqiptarët dhe i pamoralshëm? Ju mund të bënë raport ndoshta edhe më të rëndë nëse kishte të vërteta por, thjesht, të deklaroj, nuk mendoj se në një akt të tillë ka të drejtë dhe moral në deklaruesin.

Është e quartë se: "Sado që ne mendojmë se e vërteta qëndron ndryshe, njerëzit në Brazil, Indi, Nepal e kudo tjetër njoftohen për Kosovën nga ajo çfarë shkruhet dhe flitet në media... çfarë ndikimi do të kenë akuzat e Dickut që tërheqin vëmendjen e të gjitha mediumeve botërore?"

Arsyetimi dhe pyetja shtrohen shumë me vend, por ne dimë edhe që pikërisht ky ishte qëllimi i këtij rapporti famëkeq. Askush nuk duhet të mendojë se Dik Marty, duke punuar për këtë raport, nuk ka pasur këtë synim dhe se nuk i ka ditur rrjedhojat kundërsqiptare që do të lindnin në këtë rast. Prandaj edhe këtu na kujtohet ajo fabula e famshme, kur ujku i thotë qengjit po ma turbullon ujut në të përpjetë. Po, ky raport na ka dëmtuar në opinion, mediat i kanë dhënë shumë hapësirë. Por jo të gjithë janë mashtruar. Jo zotëri Marty, sado të paguhesh ti, sado të punosh kundër shqiptarëve, identitetit, autoritetit dhe fisnikërisë së tyre, ne nuk jemi nga ata që vdesim nga plagët tinëzare. Jemi plagosur shumë herë kështu, por ja ku jemi dhe do të jemi zotëri Marty, me gjithë lodhjen tende kundër nesh. Na vjen keq për pronarët e t'u serbë, të cilët, megjithëse kanë paguar, nuk do të mund të na kthejnë edhe një herë prapa në ecjen tonë drejt të ardhmes. Na kanë vonuar mjaft ata dhe të paguarit si ti zotëri, pasi nuk je i pari në këtë rrugë dhe jam i sigurt as i fundit. Le ta vërtetësraportin tënd Gjykata Speciale dhe do të meritosh një përmendore në mes të Beogradit. Por asgjë nuk do të vërtetohet, sepse asgjë nuk do të vërtetë nga ato që shpifin Ju.

Sot shumëkush dëgjoi të thotë se për shkak të diplomacisë së dobët gjendemi në këtë pozitë të dobët. Ne vërtet kemi shumë dobësi në punën tonë diplomatike, por për këtë çështjen e marrjes dhe trafikimit të organeve unë nuk mendoj se është dobësi e jona dhe për këtë më duket se ka një arsy shumë të qëndrueshme. Në Kosovë serbët kanë vrarë mbi 12 mijë civilë në rrethana krejt të panjohura dhe përgjithësisht

jashtë vëzhgimit të të tjerëve. Prej këtyre mbi 2 000 civilë të moshave dhe të sekseve të ndryshme janë vrarë pasi janë grabitur e zhdukur. Rreth 2 000 janë edhe sot të pagjetur. Këtë praktikën e grabitjes dhe të vrasjes serbët e kanë praktikuar periodikisht edhe gjatë gjithë kohës kur Kosova ishte e pushtuar nga Serbia. Por shqiptarët me gjithë ankesat dhe protestat e vazhdueshme dje dje sot për këto çështje, në asnjë moment nuk janë shprehur se këto shqiptarë të zhdukur janë grabitur për t'u marrë organet jetike për trafikë ose për t'i përdorur për shërimin e serbëve të sëmurë. Dhe kjo nuk është rastësore, por është traditë shqiptare, pasi shqiptarëve nuk u shkon ndërmend se mund të bëhen gjëra të tillë. Por meqenëse u kujtuan serbët, me të paguarit e tyre Karla Del Ponten dhe Dick Martyn, mua më lind një pyetje e natyrshme: Këta që janë kujtuar për një praktikë të tillë, pse i paskan grabitur dhe zhdukur mbi 2 000 civilë shqiptarë gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës në vitet 1997-1999? Natyrisht që përfundimi del vetë, ata paskan ditur t'i shfrytëzojnë këta të grabitur. Tanimë mua nuk më mbushet mendja kurrë se këta shqiptarë të grabitur nuk janë shfrytëzuar për t'u thithur gjakun deri në pikën e fundit dhe për t'u marrë të gjitha organet jetike për interesat e tyre. Dhe ata kanë pasur mundësinë ta bëjnë një gjë të tillë sepse ata kanë pasur në dispozicion policinë, ushtrinë, transportin, ruajtjen, sigurinë, shërbimin shëndetësor, institucionet shkencore, lëvizjen në ajër e në tokë etj. Kjo duket quartë kur ata hedhin idenë se mund të jenë bërë veprime të tillë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që edhe armët e municionin ishte e detyruar t'i conte në front me kuaj të marrë me qira, kur luftëtarët e plagosur të saj në vijat e frontit në qoftë se nuk do të shkonin në spitalin e Bajram Currit, të Kukësit ose në Spitalin Ushtarët në Tiranë, as që mund të mendohej të shpëtonin, pasi nuk kishte as mjekë, por edhe pajuisset thuajse mungonin dhe medikamentet ishin shumë të kufizuara.

Të gjithë e dinë se i vetmi vend ku mund të mjekoheshin e kuroheshin luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë kohë të luftës ishte Shqipëria. E duke situr situatën e kohës unë e di mirë sa vështirë ishte të sigurohej transporti nga kufiri drejt Tiranës, të mos flasim pastaj për transport të fshehtë, siç pretendohet të arsyetohet e vërtetohet nga zotëri Marty. Nisur nga sa u tha më sipër, unë shtroj dy pyetje: A do të na japë dot siguri politika dhe shkenca botërore se ku kanë përfunduar gjaku dhe organet jetike të të

zhdukurve shqiptarë nga Serbia në vitet 1997-1999? Dhe, së dyti, a do të bëjë një raport të dytë Dick Marty dhe Këshilli i Evropës, pasi të përfundojnë hetimet e Gjykatës Speciale, për të treguar se në reportin e parë kanë mashtruar dhe se asgjë prej tij nuk është vërtetuar e t'i kërkohet falje kombit shqiptar dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? I bëj këto dy pyetje, sepse përgjigjen për ta e konsideroj esenciale dhe me shumë vlerë për historinë e kombit shqiptar.

Por tashmë kohët po ndryshojnë. Ne shqiptarët nuk do të lejojmë më tej që figura si zotëri Marty në bashkëpunim me Serbinë të ndërtojë skenarë për filma mafiozë me portretet e shqiptarëve, siç po tentohet. Do të kërkojmë edhe ne të na tregohet çdo gjë që ka ndodhur me njerëzit tanë, pasi zotëri Marty na mësoi se ndodhka edhe një gjë e tillë, që ata nuk qenkan marrë thjesht për t'u vrarë, por qenkan marrë për t'u shfrytëzuar për interesat e Serbisë e të Serbëve e, ndoshta, më tej me gjak e me organe jetike. Çfarë mostrash.

Studenti Dimal Bashanë John Jay College of Criminal Justice në Nju Jork, në shkrimin e tij shprehet: "... akuzat qesharake që u shpalosen në të përditshmen serbe 'Novosti' thonë se 'organet e nxjerra, shqiptarët i kishin transportuar me helikopter privat në frigorifer special portativë'. Nuk duhet të na vijë turp t'u tregojmë se edhe gjysma e 'kallashëve' që posedonin ushtarët nuk funksiononin tamam, por sikur që të kishim helikopterë, siç pretendon 'dëshmitar' për "Novosti"-n, do t'i kishim përdorur për luftë e jo për transport të organeve. Ushtarët tanë kanë vdekur për kujdesin edhe më të vogël mjekësor dhe për mungesë medikamentesh, andaj ushtria jonë nuk ka pasur mjek që të ushtrojnë operacione kaq të sofistikuara.

Një arsyetim që duket se nuk le gjë për të shtuar. Por as nuk duhet menduar se zoti Dick Marty nuk e di këtë. Ai ka informacione të plota, por nuk ka nevojë t'i shfrytëzojë ato, pasi është me shërbim dhe shërbimi i tij duhet të realizohet në interes të padronit që e paguan. Detyra e tij është që ta luftojë imazhin kombëtar shqiptar, ta luftojë imazhin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ta mbush opinionin ndërkombëtar me arsyetime të gjenjeshtërtë.

Nëse ne do të kishim pasur mundësi ta paguanim zotëri Martyn, ai padyshim se do ta kishte më të lehtë të punonte për interesin e shqiptarëve, pasi faktet janë në drithë të diellit. Por ne nuk e kemi bërë këtë përfunduar arsyet që shqiptarët do të janë avokatët më të mirë për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së..."?

(Vijon)

asnijëherë për shpifje të pavërtetura; e dyta, se nuk kishim aq para sa të paguanim një njeri të gatshëm për të bërë atë punë që bëri ky zotëri; si dhe e treta, se nuk i njohim ata tipa si i këtij zotërisë, pasi kurrë nuk jemi marrë me të tillë, punëtona gjithnjë jemi përpjekur t'i bëjmë ndershëm. Prandaj edhe nuk hezitojmë të arsyojmë se për këtë reportin e Dik Martyn: "... është e ditur se qëllimi i tij final është prishja e imazhit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, si dhe pengimi i integrimit të saj në Bashkimin Evropian".

Kjo mendoj se është përgjigja për pyetjen që bëj në fillim, se a ekzistojnë e drejta dhe morali te zotëri Marty? Pasi shihet se vetëm të drejtë e të vërtetë nuk ka në praktikën e tij për këtë çështje, që është me shumë rëndësi për portretin kombëtar shqiptar, mbi të cilin ai është munduar të hedhë plehra. Ne në ushtri kemi pasur një parim, sipas të cilit, nëse armët nuk i ke në nivelin e armëve të armikut ose më moderne e të sofistikuara se ai, nuk duhet hyrë në betejë se je i destinuar të humbasësh. Pra, armiku duhet luftuar me ato armë që të lufton. Por a duhet ne kombëtarisht të biem në nivelin e mashtruesit dhe shpifësit, në të cilin ka rënë zotëri Marty për interesat personale, pasi nuk kam dëshirë të besoj se ai ka në gjen urejtje patologjike për shqiptarët, megjithë mund të jetë edhe kjo, pasi vetëm gjenjeshta pa mbështetje shpirtërore nuk mund të dalë mbi të drejtën dhe të vërtetën, sepse nuk arrin të krijojë bindje të pranueshme te të tjerët, ndërsa zotëri Marty ia arriti qëllimit të marrë pas vetes gjithë Parlamentin Evropian dhe reporti i tij të bëhet report i Evropës e të ngrihet kjo Gjykatë Speciale për t'i gjykuar për "krime" luftëtarët e lirisë që luftuan në radhët e UÇK-së, si e vërmja gjykatë në historinë botërore që gjykon mbrojtësit e viktimate. Një eksperiment i Evropës ky mbi një komb që asnijëherë nuk i ka bërë keq, përvëse e ka mbrojtur nga të gjitha invazionet e Lindjes.

Vërtet zotëri Marty, a ekzistojnë e drejta dhe morali tek ju? Sepse me reportin që keni bërë, mua që lexoi edhe literaturë serbe, më duket se nuk ekziston, pasi ju gjithçka e keni marrë prej shpifjeve serbe. Si nuk ia bëre vetes pyetjen: Çfarë ka ndodhur me mbi 2 000 shqiptarët e grabitur dhe të zhdukur nga serbët? Si ta mbushën mendjen se shqiptarët mund të jenë qengja që t'i therë bashkë me serbët, apo këtë mendje kishe edhe vetë? A nuk e di zotëri se "shqiptarët do të janë avokatët më të mirë për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së..."?

(Vijon)

# Vincenzo Peruggia, vjedhësi që e bëri legjendë tablonë "Mona Lisa"



Mona Lisa mund të jetë fytyra më e njohur në faqë të dheut. E spikatur në emisione televizive dhe në filma të panumërt, e parodizuar në format nga më të ndryshme në krejt globin, e përmendur në libra arti në çdo gjuhë, Mona Lisa ka një fytyrë që tërheq çdo vit mbi shtatë milion njerëz në Louvre të Parisit.

Secili nga këto vizitorë do të shohë nga afér, se Mona Lisa është shumë e vogël, saktësisht 76cm x 53cm. Nuk ngjason me veprat e tjera të Rilindjes sepse nuk është masive, apo të bjerë në sy menjëherë, apo të shkaktojë ndonjë emocion të fortë.

Në fakt, kur Mona Lisa u vendos për here në Louvre më 1797, ajo varej në mur me pikturna të tjera dhe nuk ishte e vetme në qendër të vëmendjes sikundër sot.

Mona Lisa, natyrisht, është një vepër arti madhore e një artisti të nderuar si Leonardo da Vinci, megjithatë nuk ishin aftësitet e tij ato që e bënë pikturnë të famshme. Mona Lisa e mori famën e vërtetë prej një vjedhësi veprash arti, një italian i quajtur

Vincenzo Peruggia. Mëngjesin e të hënës, të 21 gushtit 1911, Peruggia doli jashtë nga Louvre, pa u pikasur me Mona Lisa-n të fshehur nën përparsën e punës.

Peruggia nuk ishte ndonjë fytyrë e panjohur në muze. Ai ishte duarshkathët, i punësuar herë pas here për të punuar me xham mbrojtës për eksponatet. Ai ishte punuar me një numër pikturnash të

shtrenja dhe të bukura në Louvre, por edhe në muzetë e tjerë. Atëherë, përsë e vodhi Mona Lisa-n?

Për Vicenzo Peruggia-n kjo ishte një çështje patriotizmi. Gabimisht kishte menduar se Mona Lisa ishte vjedhur në Itali në kohën e Napoleonit dhe besonte se ishte dytë e tij t'a kthente këtë tablo



atdheut.

Ai e fshehu tablonë në një WC të muzeut natën e së dielës, duke e ditur se do të ishte i mbyllur të hënën dhe mund ta vidhë qetësisht e të largohej.

Sidoqoftë, gjatë marrjes në pyetje pas dy vjetësh, Peruggia tha se thjesht kishte ardhur të hënën në mëngjes me punëtorë të tjerë, kishte pritur deri sa galeria që mbante Mona Lisa-n të zbrajë, e

kishte marrë pikturnë nga muri, e kishte fshehur nën përparsën e punës dhe kishte dale jashtë. Në fakt, stafi i Louvre nuk e pikasi menjëherë mungesën deri të nesërmën. Ndonjëherë pikturnat hiqeshin nga muri për t'u fotografuar, ndaj s'ishte diçka e pazakontë që njëra prej tyre të mungonte. Megjithatë, kur rojet e sigurisë pyetën fotografët, zbuluan se pikturna ishte vjedhur.

Kur policia nisi hetimin, Peruggia ndodhej në shtëpi duke e futur Mona Lisa-n në një sënduk në apartamentin e tij, pa i shkuar aspak nëpër mend se kjo vjedhje sapo kishte ndryshuar historinë e artit.

Përgjatë dy viteve në vijim, vjedhja e Mona Lisa-s u bë lajm ndërkombëtar. Kjo ngjarje u përhap përmes gazetave në të gjithë Francën dhe



në mbarë botën, duke u publikuar edhe nga New York Times.

Ndërkohë, policia kërkoi me dëshpërim për hajdutin dhe hetoi plot të dyshuar, përfshi poetin e mirënjohur Guillaume Apollinaire, i cili njëherë kishte bërë thirrje që Louvre të digj, e që tashmë zotëronte disa statuja të vogla të cilat ishin vjedhur nga Louvre. Policia mendoi se burri që kishte vjedhur statujat, mund të kishte



edhe Mona Lisa-n.

Kur policia e mori në pyetje Apollinaire-in për Mona Lisa-n dhe për statujat, për këtë të fundit ai implikoi mikun e tij, një piktor i ri spanjoll që quhej Pablo Picasso. Thuhet se Apollinaire dhe Picasso qanë gjatë marrjes në pyetje dhe në fund policia kuptoi se asnjëri prej tyre nuk ishte burri që kërkonin.

Pas vjedhjes muzeu i Louvre-it ishte mbyllur për një javë. Megjithatë kur u rihap, njerëzit po mbanin radhën vetëm që të futeshin e të shikonin vendin ku më parë qëndronte pikturna e Mona Lisa-s. Madje deri në Kaliforni e dinin me saktësi se ç'pamje kishte kjo pikture e vogël nga Franca, sepse e kishin parë vazhdimisht në gazeta, si një lloj krimi sensacional.

Nëse Vincenzo Peruggia do të kishte vjedhur një pikturnë tjetër, kjo vepër arti mund të ishte bërë po aq lehtësisht pikturna më e famshme në botë, dhe Mona Lisa nuk do të bëhej aq e njohur sa ç'është sot.

Por për shkak të vjedhjes, Mona Lisa u bë vepra e parë e artit që shihej dhe shpërndahet në të gjithë botën, gjatë një kohe kur komunikimi masiv ishte ende në hapat e parë. Një vepër arti e cila më parë kishte qenë thjesht një drejtëkëndësh i vogël në një mur të mbushur me pikturna, tashmë ishte bërë epicendra e një skandali global.

Ndërkohë, planet e Peruggia-s për t'iua shitur pikturnën një galerie arti në Itali, u ndërprenë. Me famën e re të Mona Lisa-s, çdo përpjekje

për ta ofruar kundrejt shpërbimit, apo për ta shitur, mund të rezultonte në arrestimin e tij. Ndaj, qëndroi brenda një sënduku, për dy vite.

Më në fund, në vitin 1913, Vincenzo Peruggia-s po i humbte durimi. Ai kontakttoi Alfredo Gerini, një tregtar veprash arti në Firence, për t'iua kthyer Mona Lisa-n "vendlindjes" në këmbim të shpërbimit. Geri i tha Peruggia-s ta takonte te Galeria Uffizi, për ta verifikuar pikturnën.

Kur Peruggia ia dorëzoi, Geri premtoi se do ta mbante në një vend të sigurt, megjithatë ai telefonoi policinë sapo Peruggia u largua. Hajduti i veprave të artit u arrestua në hotelin ku po qëndronte, Mona Lisa u rimor dhe krimi që shkundi botën, i erdhë fundi.

Galeria Uffizi e eksposoi pikturnën për dy javë, përpëra se të kthej zyrtarisht në Louvre, në 4 janar të vitit 1914. Që nga ajo kohë, kanë ndodhur disa incidente ku individë përpiken ta dëmtojnë Mona Lisa-n, por nuk ka pasur më vjedhje. Sot pikturna ka një mur të veçantë në Louvre dhe mbrohet nga një xham antiplumb, me ajër të kondicionuar.

Përsai përkthet Vincenzo Peruggia-s, ai u burgos për gjashtë muaj dhe Italia e vlerësoi për atdhetarizmin e treguar. Ai shërbuej në ushtrinë italiane gjatë Luftës së Parë Botërore dhe në fund u shpërulgul sërisht në Francë, ku hapi një punishtë për pikturna, të cilën e zotëroi deri kur vdiq në vitin 1925. (Exlibris.al / Përktheu David Hudhri)



**ROYAL CROWN**  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULE

gluten free

100% mish puk

cilësi e garantuar

pa konservues

E rrallë

## Një burrë e zë peshkun nga goma e pishinës

Peshkimi si hobi është shumë i vjetër. Peshkimi ka qenë një burim i madh i ushqimit në kohën parahistorike. Me teknika të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të peshkimit, njerëzit mund ta shijojnë kohën e tyre në lumë, liqene apo edhe në varka të mëdha në dete. Një video tregon një burrë i zili po peshkonte nga një gomë për pishinë. Ai me gomën e tij në deti po peshkonte dhe zuri një



peshk gjigant. Shokët e tij gjiran këtë çast interesant.

FOTO E DITES



Një nënë shqiptare shihet afér televizionit duke shikuar fjalimin e presidentit Hashim Thaci pas kthimit nga Haga.



**DASHI**  
Ju mund të filloni të nisni apo të vazhdoni projekte të reja, duke përfituar edhe falë hyrjes së Hënës në shenjën tuaj që do t'ju mbrojë.



**DEMI**  
Eshtë një ditë që do të ishte më mirë t'i shmangni konfliktet, veçanërisht në dashuri.



**BINJAKËT**  
Kjo ditë mund të jetë e përshtatshme përfi t'i zgjidhur diskutimet në fushën sentimentale.



**GAFORRJA**  
Disa prej jush janë duke përfjetuar disa probleme pune, por vazhdoni t'i zgjidhni ato në kohë.



**LUANI**  
Dita mund të jetë pak e ashpër. Këshilla eshtë që të përiqeni të qëndroni të qetë dhe ta përdorni këtë kohë përfi t'qëndruar së bashku me njerëzit.



**VIRGJËRESHA**  
Disa konflikte mund të lindin në sferën personale. Në vend se të acaroheni kundër atyre që keni përreth, do të ishte më mirë të organizoni një udhëtim.



**PESHORJA**  
Përfiton nga koha përfi t'folur edhe nëse situata nuk eshtë më e mira përfi ta bërë atë. Mundohuni të relaksoheni pak.



**AKREPI**  
Padyshim një ditë pozitive, veçanërisht përfi sa iu përket takimeve dhe kontakteve me t'jera.



**SHIGJETARI**  
Ditë shumë pozitive në të cilën më në fund mund t'i rikuperoni marrëdhëniet me partnerin tuaj.



**BRICJAPI**  
Do të jetë një ditë e tëra në dorën tuaj. Ju mund t'a gjeni veten të detyruar t'përballeni me disa çështje sentimentale.



**UJORI**  
Do të jetë një ditë pozitive dhe plot energji. Në vendin e punës eshtë më mirë t'ë shikoni pak rrëth e jo t'i përashton përfyshimet.



**PESHQIT**  
Kjo përfi ju eshtë një periudhë ndryshimi veçanërisht në nivel shpirtëror. Natyrish, situata ndonjëherë ju bën paksa nervoz.

## BARSOLETA E DITËS



Një letër anonime vjen në zyrën e taksave:  
- Nuk kam mundur të fle kohën e fundit përfi shkak të mosdekclarimit të saktë të fitimeve që kam marrë prej dyqanit.

Brenda në letër kishte një shumë të madhe të hollash dhe një poshtshënim:

- Në qoftë se nuk më zë gjumi as sonte, do ta sjell pjesën tjetër nesër.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

## Një çift ndërton një shtëpi të mahnitshme nga kontejneri

Nuk eshtë shumë e vështirë që të gjeni një zgjidhe përfi t'ndërtuar një shtëpi sepse ka materiale të ndryshme nga të cilat mund të vini në një përfundim shumë të bukur. Njerëzit përdorin materiale të ndryshme duke filluar me riciklimin e tyre e deri te kontejnerët, përfi ta realizuar idenë dështëpinë e endrrave.

Një çift, Jaimei dhe Dave, kanë përdorur një kontejner që t'ndërtuan një shtëpi atë ata shfrytëzuan shumë ide që kishin dhe më pas e rregulluan më gjérat e tjera të nevojshme. Çifti e ndërttoi këtë shtëpi të bukur, në të cilën ata kanë çdo gjë që ju duhet dështë. Një pamje shumë karakteristike.



## Faktet që provojnë se Angelina Jolie ka zemër prej floriri



**A**jo ka dëshmuar se ndien vuajtjen e të tjerëve dhe përpinqet ta ndryshojë për më mirë. Prej rrith 20 vjetësh tashmë Angelina Jolie ka bërë gjithçka në ndihmë të refugiatëve, në luftën kundër varfërisë dhe për ruajtjen e natyrës. Duke bërë të gjitha këto ajo nuk ka harruar të jetë edhe një nënë e dashur dhe inkurajuese. Rrjeti Bright Side ka hartuar një listë të gjëra të mira që aktorja e famshme

ka bërë për botën dhe që tregojnë paksa historinë e saj. Gjithçka duket se nisi në Kamboxhia, ku Angelina Jolie shkoi në vitin 2000 për ta xhiruar filmin e aksionit Lara Croft: Tomb Raider. Vendi ishte në krizë humanitare dhe kjo la shenjë tek aktorja. Ajo nisi të kërkonte përvende të tjera të trazuara në botë dhe më vonë vizitoi rrith 30 prej tyre për të dhënë ndihmë humanitare e duke punuar për njerëzit në nevojë.

## Në fshehtësi të plotë, aktorja dhe këngëtari i famshëm bëhen prindër për herë të dytë



**J**essica Biel dhe Justin Timberlake janë bërë prindër për herë të dytë, shkruan "Daily Mail". Aktorja 38-vjeçare ka sjellë në jetë një djali, në fillim të kësaj javë. Aktualisht ajo së bashku me të voglin ndodhet në shtëpi pranë bashkëshortit 39-vjeçar dhe djalit të parë, pesëv-

jeçar. Sipas "Daily Mail", nëna e aktore, 65-vjeçarja Kimberly Conroe Biel, ka kaluar pjesën më të madhe të kohës pranë vajzës dhe nipit të vogël. Madje një shoqe e saj ka zbuluar se ajo do të qëndrojë te shtëpia e së bijës deri të dielën dhe ishte pikërisht ajo që tregoi edhe gjininë e foshnjës.



## Çifti nuk fshihet më, puthje e përqafime nën objektivin e kamerave

**A**rlena Ara ka festuar ditën e 22-të. Këngëtarja është surprizuar nga miqtë dhe të afërmët e saj në mesnatën e 17 korrikut në një resort buzë detit në Drimadhes. Ashtu si edhe parë, VIP-at ishin mbledhur në festën surprizë dhe dress code ishte ngjyra e bardhë. Nuk kishte se si mos të qëndronte


Popi, i dashuri dhe menaxheri i këngëtares pas festës surprizë dedikuar partneres së tij, "Happy Birthday Kiddo, trashëgimia ime e përfjetshme", e ka uruar ai në rrjetet sociale, përkrah fotos teksha shfaqen të përqafuar. Prej vitesh Popi dhe Arilena janë të pandarë. Fillimisht ata deklaruan se punonin së bashku.

## Bashkëshortja e futbollistit të njohur "ndezi" rrjetin në "Instagram"



**W**anda Nara ka 6.6 milionë ndjekës në "Instagram", me të cilët ndan çaste nga të ndryshme nga jeta profesionale dhe private. Bashkëshortja e futbollistit të njohur, Mauro Icardi, gjithashtu publikon herë pas here edhe fotografie shumë seksi që bien në sy menjëherë.

Kështu ka ndodhur edhe së fundmi, teksha ka publikuar një fotografi ku shfaqet me të brendshme, duke ngacmuar kështu imagjinatën e fansave. Menaxherja dhe bashkëshortja e futbollistit argentinas shfaqet e shtrirë në një divan teksha shihet veshur vetëm me të brendshme.



# Selimi: Tri klubet kanë mundësi pothuajse të njëjta për titull

Trajneri i njohur në futbollin e Kosovës, Musa Selimi, ka thënë se tri skuadra e para në tabelë, Drita, Gjilani dhe Ballkani, i kanë mundësitë pothuajse të njëjta për titull. "Mund të them se gara për titull në Superligë ende është e hapur dhe tri skuadra kanë thuajse gjasat e njëjta për t'u shpallur kampion, por kjo varet edhe nga rezultatet e njëra-tjetrës", ka thënë Selimi

EPOKA  
ERE

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Gara për titull të kampionit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll është bërë edhe me interesante kur kanë mbetur edhe dy xhiro për t'u zhvilluar, pasi Drita e ka humbur derbin me Gjilanin dhe dallimi në mes tri skuadave të para është vetëm dy pikë.

Trajneri dhe njohësi i mirë i futbollit, Musa Selimi, ka thënë se gara për titull në elitën e futbollit të Kosovës është ende e hapur dhe gjasat për t'u shpallur kampione i kanë tri skuadra. "Mund të them se gara për titull në Superligë ende është e hapur dhe tri skuadra kanë pothuajse mundësi të njëjta për t'u shpallur kampione, por varet edhe nga rezultatet e njëratjetrës. Gjilani me fitoren ndaj Dritës ka bërë një hap të madh, por ende nuk dihet se kush do ta rrëmbejë trofeun e më të mirit, sepse aty është edhe Ballkani me një skuadër mjaft cilësore dhe normalisht liderja aktuale, Drita", ka thënë Selimi.

Gjilani të shtunën e ka mposhtur



skuadrën e Dritës me rezultat 2-0, kurse në derbin tjetër në mes të

**Tabela**

|               | Pikë  |
|---------------|-------|
| 1. Drita      | 31 65 |
| 2. Gjilani    | 31 64 |
| 3. Ballkani   | 31 62 |
| 4. Prishtina  | 31 59 |
| 5. Feronikeli | 31 44 |
| 6. Flamurtari | 31 43 |
| 7. Llapia     | 31 42 |
| 8. Drenica    | 31 41 |
| 9. Trepça '89 | 31 38 |
| 10. Ferizaj   | 31 29 |
| 11. Vushtrria | 31 18 |
| 12. Dukagjini | 31 16 |

Ballkanit dhe Prishtinës nuk ka pasur fitues dhe ndeshja ka përfunduar 2-2. Edhe gara përmblendetës është mjaftë e ashper, pasi gara përtu larguar nga elita po bëhet në mes të disa skuadave. Dukagjini, Ferizaj dhe Vushtrria tashmë e kanë siguruar rënien dhe në garë përmblendetës janë Trepça '89, Drenica, Llapia dhe Flamurtari, por as kampioni në fuqi i Superligës, Feronikeli, nuk e ka siguruar mblendetës. "Në garë përrënie nga Superliga, përvèç tri ekipeve që tashmë e kanë siguruar, si skuadër më të rezikuar e shoh Trepçën '89, por janë edhe dy ndeshje përtu zhvilluar dhe gjithçka mund të ndodhë", ka deklaruar Selimi.

## SHKURT

### Hamiltoni triumfon në Hungari

Një super Lewis Hamilton ka fituar garën e Çmimit të Madh të Hungarisë. Një garë pa histori që është dominuar në Hungaroring nga piloti britanik, i cili e ka mbyllur me një avatash prej 8 sekondash ndaj Red Bullit të Max Verstappenit. Në vendin e tretë ka dalë Mercedesi tjetër i Valtteri Bottas. Zhgënjen Ferrari, me Sebastian Vettelin që e ka mbyllur në vendin e shtatë dhe Charles Leclerc në të njëmbëdhjetin.

### Sanches rezulton pozitiv me Covid-19

Futbollisti i Lilles, Renato Sanches, ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Ai është lojtari i tretë që infektohet në ekipin e kategorisë së parë në Francë. Sanches ka publikuar një foto në "Instagram" ku ka shkruar: "Makina do të rikthehet së shpejt". Lille para një viti e bleu mes-fushorin portugez nga Bayern Muncheni për 20 milionë euro.

### Sadiku do të largohet nga Spanja, kjo pritet të jetë skuadra e re

Armando Sadiku mund të largohet nga Spanjë në merkaton e verës përtë kaluar në Greqi të skuadra e Arisit. Sipas asaj që shkruan së fundmi "Gazzetta.gr", skuadra greke është në një fazë të avancuar trativash, përtë afroar sulmuesin shqiptar në ekipin e tyre. Sadiku raportohet se është shumë afér arritjes së marrëveshjes me Arisin, i cili mund të jetë klub i tij i ardhshëm. I vetmi ndërlikim është fakti se Levante kërkon që pasi të kalojë tek Arisi të ruajë edhe një përqindje të kartonit të lojtarit, përtë cilin pagoi 1 milion euro përtë afroar dy vjet më parë. Ekziston edhe mundësia që Sadiku të kalojë në Selanik në formën e huazimit, por Levante nuk ka ndërmend të paguajë më shumë se 100 mijë euro në sezon përtë rrogën e sulmuesit, i cili përfiton 500 mijë euro.

### Hazardi: Ky ishte sezoni më i dobët përmirësuar

Eden Hazard fitoi La Ligën me Real Madridin që në sezonin e tij të parë. Belgu vuajti dëmtimet e shumta dhe nuk ishte një sezoni mjaft i mirë në aspektin personal. Së fundmi Hazardi ka dhënë një intervistë ku ka tregues disi zhgënjimin përtë sezonin e tij të dobët në aspektin personal. "Edhe pse ky nuk ishte sezoni im më i mirë i mundshëm, jam shumë i lumtur që fitova titullin me Real Madridin. Këtë vit, falë ekipit, fituan kampionatin. Në aspektin personal mund të them se ka qenë sezoni më i dobët në karrierë", ka thënë Hazardi. Belgu foli edhe përmarrëdhënien e tij me trajnerin Zidane. "Si lojtar ka qenë ndër më të mirët. Si trajner nuk kam asgjë përtë thënë pasi titujt flasin vetë. Ai beson te lojtarët e tij. Kjo është arsyaja se pse funksionon gjithçka", ka deklaruar Hazardi.

## Todt: Kam takuar Schumacherin, shumë shpejt do ta shihni të gjithë

**PIERREPORT, 19 KORRIK** - Lajme pozitive mbi shëndetin e pilotit gjerman të Formulës 1, Michael Schumacher, teksha së fundi ka qenë ish-drejtues i skuadrës së Ferrarit, aktualisht drejtues i Federatës Ndërkontinentale të Automobilizmit, Jean Todt, që

ka folur për këtë çështje. Në një deklaratë të dhënë së fundi, Todt ka treguar se ka pasur mundësi ta shohë Schumacherin javën e kaluar dhe se bëri parashikimin optimist se shumë shpejt e gjithë tjetë se shumë shpejt e gjithë bota do të mund të shohë shtatë herë kampionin e botës

në Formula 1. "E pashë Michael javën e kaluar dhe besoj se shumë shpejt do ta shohë e gjithë bota. Është duke luftuar dhe shpresoj që shumë shpejt të kenë mundësi të gjithë ta shohin. Familja e tij dhe ai po përpilen përkëtë", u shpreh Jean Todt.

Piloti gjerman u akidentua në alpet franceze në dhjetor të 2013-s dhe që atëherë ka kaluar vështirësi të mëdha shëndetësore, por familja është munduar të ruajë gjithçka në sekret të plotë, duke mos dhënë detaje mbi ecurinë e rehabilitimit të tij.



## Mezani: Objektiv kemi Evropën, por jemi gati të luajmë për titull

**GJILANI, 19 KORRIK** - Gjilani e fitoi derbin e Anamoravës përballë Dritës me shifrat 2-0 dhe është futur plotësisht në garën për titullin kampion të IPKO Superligës së Kosovës, kur kanë mbetur edhe dy javë nga fundi i kampionatit. Trajneri i gjilanasve, Gentian Mezani, ishte në një lidhje të drejtpërdrejtë me emisionin "Gol pas goli" në Supersport, ku u shfaq mjaft i lumtur përfitoren në derbi, por theksoi se objektivi primar i të tijve është një vend në zonën evropiane.

*Sa shanse ka Gjilani ta fitojë titullin kampion, pas triumfit në derbin e qytetit përballë Dritës?*

**Mezani:** Duhet të pranojmë se objektivi ynë fillestar ishte një vend në Kupën e Evropës, por kur kanë mbetur edhe dy javë nga fundi, jemi plotësisht në garë për titullin kampion. Jemi shumë të lumtur përfitoren në derbin ndaj Dritës, por duhet të rrrimë me këmbë në tokë dhe të përgatitemi për ndeshjen me Ballkanin, që është një kundërshtar shumë i fortë.

*Pse u luajt pa tifozë, pasi në Suharekë kishte publik në shkallët e stadiumit?*

**Mezani:** Nuk e di si u luajt në



sfidën Ballkani - Prishtina, por edhe këtu pati grumbullim tifozësh rrëth stadiumit, ndonëse nuk u lejuan të hyjnë në shkallët e stadiumit, ndoshta edhe përfaktin se tifozët në këtë qytet janë shumë të zjarrtë.

*Ballkani është skuadra kyçe në garën për titull. A i trembeni një lëshimi në javën e fundit, nëse e imposhtni në javën e ardhshme?*

**Mezani:** Siç e thashë, ne duhet të përqendrohem te puna jonë dhe ta marrim maksimumin në ndeshjet tona, pa menduar

çfarë po ndodh në stadiumet e tjera. Nëse bëjmë këtë, do të jemi të sigurt që do ta arrijmë objektivin tonë, një vend në Evropë, pastaj nëse vjen edhe titulli, do të jetë akoma më bukur.

*Çfarë ndryshimi ka mes futbollit në Shqipëri dhe atij në Kosovë?*

**Mezani:** Kategoria Superiore është një hap përpëra pasi është më e qartë taktikisht dhe me ritëm më të lartë. Këtu luhet një futboll më i avashtë dhe më i ashper.

## Newcastle synon transferimin e Ronaldos dhe Benzemas

Newcastle United po mendon përmes merkaton e verës dhe ideja e tyre është e çmendur. "Qymyrxhinjtë" nuk do të kenë probleme me paratë, pasi drejtuesit e tyre të ardhshëm janë njerëzit më të pasur në botë. Emri i parë në merkaton e verës është Cristiano Ronaldo. Portugezi është 35-vjeçar, por drejtuesit besojnë se ai mund të jetë lideri i tyre. Ata nuk e kanë problem ta bindin në aspektin monetar, ndërsa në krahun tjetër ylli mund të rikthehet sërisht në Premier Ligë, përpëra se ta mbyllë karrierën në MLS siç dëshiron. Ronaldo nuk do të jetë futbollisti i vetëm që kërkon Newcastle, pasi ata



duan t'i bashkëngjisin dhe Benzemës. Të dy njihen mirë me njëri-tjetrin që prej kohës kur kanë luajtur te Real Madridi. Newcastle kërkon të

rikthejë sërisht një pjesë te Realit në Angli. Ata janë gati të paguajnë deri në 50 milionë euro përfundezin sipas asaj që shkruan "Don Balon".

## SHKURT

### Interi rikthen interesimin për Kumbullën

Interi ka rifilluar bisedimet me Hellas Veroran për mbrojtësin Marash Kumbulla, i cili kërkohet edhe nga Lazio dhe Juventusi, transmeton "Zeri.info". Kumbulla dukej se ishte shumë afër transferimit te Lazio, por këta zëra kanë heshtur së fundmi dhe "Sky Sport Italia" raporton se Interi sërisht ka kthyer vëmendjen kah reprezentuesi shqiptar. Raportohet se zikaltrit kanë biseduar me Veroran ditët e fundit, por ende nuk janë në nxitim përfunduar transferimin e tij. Pavarësisht kësaj, Verona është duke mbajtur të hapura të gjitha mundësitë, derisa për shqiptarin interesim është duke shprehur edhe Juventusi. Kumbulla ka shkëlqyer gjatë këtij edicioni në Serinë A, duke tërhequr vëmendjen e shumë klubave.

### Rrahmani: Pikë e rëndësishëm në ndeshje të vështirë

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës dhe futbollisti i Hellas Veronës, Amir Rrahmani, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e skuadrës dhe barazimin (1-1) ndaj Atalantës. Golat në këtë ndeshje i shënuan Duvan Zapata, në minutën e 50-të të ndeshjes dhe Matteo Pessina në minutën e 59-të. "Një pikë tjetër në një ndeshje të vështirë. Mezi po pres ta përfundojmë këtë sezoni të suksesshëm", ka shkruar Rrahmani.

### Bielsa nderohet me emër rruge nga Leeds

Tifozët e Leeds Unitedit kanë vazhduar festimet përfundimtarë të tyre në Premier Ligë. Pritja e gjatë prej 16 vjetësh më në fund mbaroi dhe klubu nga Yorkshire do të jetë sërisht mes më të mirëve. Trajneri i Leedsit, Marcelo Bielsa, tashmë është kthyer në një hero përfundimtar dhe qytetin. Tekniku argjentinës ishte ai që mori timonin e ekipe dhe tashmë tifozët kanë gjetur një mënyrë krejt speciale përfundimtarë. Sipas raportimit të "The Athletic", një rrugë në lagjen Trinity në Leeds do të quhet Marcelo Bielsa. Ceremonia pritet të mbahet javën tjetër dhe pritet të jetë një numër i madh tifozësh. Kujtojmë se vetëm pak ditë më parë ata "pushtuan" shtëpinë e Bielsës, duke e besuar argjentinasin.

### Calhanoglu: Jemi me fat që kemi Piolin te Milani

Milani është ringjallur pas pauzës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, duke marrë disa fitore radhazi tashmë në Serinë A. Forma e lartë sigurisht vjen edhe si pasojë e punës së trajnerit dhe këtë e di edhe Hakan Calhanoglu, i cili ka thënë se Milani është me fat që ka Stefano Pioli. "Jam i lumtur. Ne kemi luajtur shumë ndeshje me këtë sistem dhe këtë pozitë. Kështu dua të luaj. Pioli më lejon të luaj në mënyrën si dua. Ne jemi me fat që kemi një trajner si ai përfundimtar", ka thënë Calhanoglu. Milani është pretendent kryesor përfundimtar në një vend në Ligën e Evropës, vend përfundimtar në cilin garon me Romën dhe Napolin.

### Juve e ka seriozisht interesimin përfundimtarë

Juventus është duke e menduar seriozisht transferimin e Duvan Zapatas nga Atalanta. "Zonja e Vjetër" është e gatshme që të ofrojë 30 milionë euro dhe shërbimet e Mattia Perin përfundimtarë. Sulumësin nga rivali i Serinës A, Arkadiusz Milik, Edin Dzeko dhe Alexandre Lacazette ishin në listën e preferuar të "Zonjës së Vjetër", mirëpo "Corriere dello Sport" shkruan se Zapata po i përfundimtarë. Sipas mediumit italiane, bisedimet mes Fabio Paraticit dhe zyrtarëve të Atalantas kanë filluar tashmë. Paratici thuhet se ka ofruar 30 milionë euro dhe shërbimet e Perin, që aktualisht është në huazim te Genoa. Zapata po kalon nëpërfundimtarë formë të lartë në këtë edicion, duke shënuar 18 gola dhe forma e tij është vërejtur edhe nga disa skuadra evropiane.

**Lume's Details**  
*Estetik & Depilim*

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA PRISHTINË

Tel: +377 45 400 156 | +386 49 848 553

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- Emira Morina shpall të pavlefhme diplomën e shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Drenas.
  - Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, katër III-Lagja Mati 1 Rr. Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira përfshirë afat të gjatë. Tel: +38344185233.
  - Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet përfshirë një qift ose përfshirë dy vajza. Tel: 044171328.
  - Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë se pse shtëpia ka nevojë përfshirë afat të gjatë. Ndërsa shpenzimet mujore ti bëjnë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
  - Lëshoj banesë me qira përfshirë student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër detyrë ndërtim i ri. Tel: 044-686-900.
  - Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
  - Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, katër detyrë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
  - Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpianë katër i parë, posedon tre shtëpi të dhë e mobiluar. Preferohet përfshirë studentë ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
  - Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përfshirë banim, preferohet përfshirë një qift apo tre studentë, mund të merret përfshirë një shtëpi apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
  - Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188.
  - Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Përfshirë informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275.
  - Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër i tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.
  - Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfshirë info 044/332-640.
  - Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Përfshirë info 044/332-640.
  - Lëshoj banesë me qira e cila gjendet përball AAK-së me kushtet përfshirë afat të gjatë. Ndërsa shpenzimet mujore ti bëjnë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: +37744162783 dhe 049/900-994.
  - Lëshoj banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, përfshirë info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
  - Lëshoj banesë me qira, e cila gjendet përball AAK-së, me kushtet përfshirë afat të gjatë. Ndërsa shpenzimet mujore ti bëjnë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: +37744162783.
  - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Përfshirë informata në tel. 044/171-328.
  - Lëshoj banesë e re me qera në qendër të përball Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet përfshirë afat të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber).
  - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Përfshirë info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
  - Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Përfshirë informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
  - Lëshoj me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme përfshirë banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
  - Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Përfshirë informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në këtë numër njerëzor.
  - Kërkojmë 4 bashkëbanues, studentë, banesa gjendet te Parku i qytetit, katër i l-ri, ka 3 dhoma, dy banjo, ballkon, çmimi përfshirë person është 50 euro plus shpenzimet. Përfshirë info: 045/699-221.
  - Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
  - Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Përfshirë informata lajmërohuni në tel: 044/162-783.
  - Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, katër i -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
  - Kërkojmë dy bashkëbanues, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së), ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesa mund të shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
  - Shesim banesë dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 katër i -III-. Çmimi 77 000€. Informata tel: 049/400-958 dhe 044/627-387.